



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Përbashkët i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
(Program i Integruar) në “Farmaci”
Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asc. Brunilda MYFTARI

PhD. Driton VLLASALIU

Tetor / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Msc (PI) në "Farmaci"

1	IAL aplikues:	Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Farmacisë (tre departamentet): 1. Departamenti i Shkencave Farmaceutike; 2. Departamenti i Teknologjive Kimiko – Farmaceutike dhe Biomolekulare; 3. Departamenti i Vlerësimit Kimik-Teknologjik dhe Farmakologjik të Barnave;
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc i Integruar në Farmaci
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 567, datë 27.08.2004
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë nga MASH Nr. 661. prot, datë 31.01.2007
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 219, datë 14.11.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 339, datë 16.09.2015
8	Cikli i studimit:	Cikli II (i integruar)
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha italiane
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Universitetin "Aldo Moro" të Barit, Itali
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	La Laurea Magistrale a Ciclo Unico in "Farmacia"
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	28 PAE / 11 PAK
18	Numri i studentëve:	226 studentë *
19	Komente / të tjera:	-

* Numri i studentëve është paraqitur për ciklin e plotë të studimit (5 vite akademike)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 567, datë 27.08.2004. Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Veprimtaria e Universitetit fillon në vitin akademik 2004 – 2005 me dy fakultete. Ky Universitet ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.112, date 15.12.2017, me kohëzgjatje 6 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2023.

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, është i organizuar në 4 fakultete:

1. Fakulteti i Farmacisë;
2. Fakulteti i Mjekësisë;
3. Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale;
4. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e integruar të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” licensuar me VKM Nr. 567, datë 27.08.2004 si diplomë universitare të specialitetit në “Farmaci dhe farmaci industriale”, 5 vite akademike. Me shkresë Nr. 661 prot, datë 31.01/2007 të MASH është ndryshuar emërtimi i programit në "Farmaci" pa patur asnjë ndryshim në brendi të programit. Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Farmacisë dhe është program i përbashkët studimi dhe ofrohet që nga viti akademik 2014 -20015 së bashku me Universitetin “Aldo Moro” të Barit, në përputhje me marrëveshjen mes dy institucioneve. Programi është akredituar për herë të parë, me UMASH Nr. 339, datë 16.09.2015, në bazë të vendimit Nr.44, datë 05.05.2015 të Këshillit të Akreditimit.

Në fund të studimeve, lëshohet një diplomë e përbashkët nga Universiteti i Barit “Aldo Moro” dhe Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”. Duhet theksuar që programi i integruar Master i Shkencave në “Farmaci” është akredituar gjithashtu në Universitetin e Barit nga Ministria Italiane e Arsimit, Universitetit dhe Kërkimit. Ky program synon të ofrojë formim profesional dhe të përgatisë punonjësit e ardhshëm për sektorin farmaceutik publik dhe privat. Formimi i profesionistëve me njohuri dhe aftësi për të marrë vendime, analizuar dhe zgjidhur probleme në situata të vështira në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucioneve ku ata do punojnë e kontribuojnë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përshtatjes së moduleve me legjislacionin dhe kontekstin shqiptar, në të cilin ndërmarrja ushtron aktivitetin e saj. Diploma e

përbashkët dhe pjesëmarrja në mësimdhënie e pedagogëve garanton cilësinë e procesit, por në të njëjtë kohë bën që të diplomuarit të jenë konkurrues dhe të pranueshëm në tregun europian.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Master i Shkencave (PI) në Farmaci, është akredituar me Urdhër të MAS Nr. 339, datë 16.09.2015, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 44, datë 05.05.2015. Referuar këtij vendimi Këshilli i Akreditimit **nuk ka lënë rekomandime** për këtë program studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm është bazuar në të dhënat, evidencat dhe informacionet nga njësitë bazë, pjesë e njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit, si dhe njësitë administrative në mbështetje të tij. Këto të dhëna u mbledhën nëpërmjet metodave të ndryshme të komunikimit si dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e ASCAL, intervista dhe diskutime gjatë vizitës në IAL. Evidencat dhe RVB, shërbyen si bazë për përgatitjen e raportit të jashtëm për programin e integruar të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” dhe gjithashtu si evidenca mbështetëse.

Qëllimi i këtij raporti është të japë një vlerësim të pavarur për shkallën në të cilën, Fakulteti i Farmacisë, UKZKM është i përgatitur dhe i angazhuar për të përmbushur standardet e cilësisë të diplomave që lëshon. Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat; Burimet për realizimin e këtij programi; Studentët dhe mbështetja e tyre dhe Sigurimi i cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci”.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet përmbushen plotësisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet nuk përmbushen;

Procesi i vlerësimit është administruar dhe koordinuar nga ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) është i përbërë nga Prof.Asc. Brunilda MYFTARI dhe PhD. Driton VLLASALIU, ekspertë të jashtëm vlerësimi dhe nga Znj. Majlinda DEMIRNELI, koordinatore teknike, përfaqësuese e ASCAL. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza: Vlerësimi i brendshëm ku institucioni

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

ka dorëzuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) së bashku me dokumentacionin mbështetës (DVB); Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, u zhvilluan vizitat në datat 24 dhe 25 Maj 2021 sipas një agjende të përcaktuar nga GVJ në bashkëpunim me ASCAL. Gjatë vizitës në vend janë takuar aktorët kryesorë të këtij institucioni dhe studentët. Këto takime kanë ndihmuar në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) nga GVJ.

GVJ konkludon në rekomandimet përkatëse bazuar në plotësimin e standarteve në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave (PI) në "Farmaci".

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 20.09.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 135 / 12 Prot, datë 20.09.2021. Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", përcjell në ASCAL më datë 01 Tetor, me anë të shkresës me Nr. 108/1 Prot, datë 28.09.2021, "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm", ku Institucioni nuk përcjell komente mbi vlerësimin e kryer nga Ekspertët ,vetëm sqaron disa çështje, në këtë mënyrë Draft Raporti kthehet në Raport Final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Msc (PI) në "FARMACI"

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi "Master i shkencave" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se Programi 'Master i Shkencave në Farmaci' i ofruar nga UKZKM ka qëllim të krijojë specialistë dhe profesionistë të rinj të edukuar me standarde evropiane në mënyrë që të mbështesin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë, prandaj, programi i IAL i kontribon pozitivisht shëndetësisë dhe interesave kombëtare. Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në "Farmaci" është licensuar me VKM Nr. 567, datë 27.08.2004 si diplomë universitare DIND, që

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>zgjat 5 vite akademike. Qysh prej vitit akademik 2014 -2015 ky program ofrohet në bashkëpunim me Universitetin “Aldo Moro” të Barit, në bazë të një marrëveshjeje mes dy institucioneve dhe në përfundim të tij lëshohet diplomë e përbashkët. Kjo diplomë iu shërben të rinjve shqiptarë të punësohen si brenda dhe jashtë vendit. Në dritën e këtyre të dhënave GVJ vlerëson se ky kriter përmbushet plotësisht.</p>			
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Fakulteti i Farmacisë, me 3 njësitë bazë përbërëse të tij, është njësia përgjegjëse e ofrimit të programit të studimit në bashkëpunim me strukturat mbështetëse të UKZKM, dhe si itillë bazuar në RVB ka si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Programi zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Farmacisë, Shkencave të Barnave të Universitetit të Barit dhe në përfundim rezulton me lëshimin e një titulli studimi të përbashkët. Ky bashkëpunim (evidenca 81, dokumenti nr. 5), jo vetëm rezulton në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, por edhe synon ta ngrrejë nivelin e këtyre vlerave në nivel Europian. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet, strategjinë dhe misionin e institucionit, sidomos sa i përket krijimit të proceseve që e suportojnë një bashkëpunim të mirëfilltë me Universitetit të Barit. Ky program rezulton në krijimin e profesionistëve me njohuri dhe aftësi të thella dhe të cilët punësohen në sektorë të ndryshëm, është e qartë se programi hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar.</p>			
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>				
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>				
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor;</p>	<p>Duke shqyrtuar DVV (evidenca 112, dokumenti nr. 54) GVJ vlerëson se programi i ofruar nga FF/UKZKM “Master i Shkencave” në Farmaci, është multidisiplinar, ofron njohuri teorike dhe praktike në fushat relevante të biologjisë, kimisë, farmaceutikës, etj. Këto i mundësojnë të diplomuarit të krijojnë baza njohurish si pajisje adekuate për të ndjekur studime të ciklit të tretë. Gjatë takimeve me IAL, GVJ kishte rastin të dëgjojë për disa shembuj të të diplomuarve që kanë përfunduar ose ndjekin aktualisht studime të thelluara të ciklit të tretë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: “Rruga e Durrësi”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi I.2

Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ konstaton se programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional. UKZKM synon të ofrojë arësim cilësor dhe trajnim profesional në nivelin evropian dhe kjo arrihet përmes partneritetit të ngushtë me UniBA me të cilin ndan të njëjtat objektiva formuese, plan mësimor, programe të lëndëve dhe ndjek një ofertë didaktike të njëjtë.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Institucioni vepron në përputhje të plotë me statutin, rregulloren e fakultetit dhe rregulloren e programit të studimit për mbarëvajtjen e procesit akademik. Programi i studimit është në përputhje dhe në zbatim të neneve 2 dhe 3 të Statutit (evidenca 89, Dokument nr. 15) të Universitetit, dhe Rregullores së Fakultetit (evidenca 90, Dokument nr. 16).
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (KSHK) dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit farmaceutik.
Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Bazuar në DVV, GVJ vlerëson se edhe plani strategjik i programit të studimit ka në vijë të parë përputhjen me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi ndan të njëjtat objektiva formues, planin mësimor, programet e lëndëve me UniBA dhe zhvillohet duke ndjekur didaktike të njëjtë. Si i tillë, mund të konsiderohet se përmbush edhe kriteret e një arsimit cilësor në nivel evropian në përputhje me interesin kombëtar synimin për t’u bërë pjesë e BE dhe akoma më tej në përputhje edhe me trendet globale të zhvillimit.
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi I.3



Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>GVJ konfirmon se objektivat e programit për formimin e studentëve përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore dhe aftësitë e kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Programi ka si synim kryesor formimin e farmacistëve si profesionist të rëndësishëm në sistemin shëndetësor si dhe industrinë, kontrollin dhe tregun farmaceutik. Të diplomuarit pajisen me bazën shkencore, teorike dhe praktike si dhe aftësitë dhe kompetencat profesionale (p.sh. komunikim) të nevojshme për të ushtruar profesionin e farmacistit në të gjitha sferat relevante, ashtu siç edhe e kërkon tregu i punës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ vëren tek evidenca në dispozicion se institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës. Nga një analizë e tillë e tregut (evidenca 92, dokumenti nr. 18) shihet se 97% e të diplomuarve të programit që janë në një marrëdhënie pune punojnë në profesion, që tregon se tregu i punës ka kërkesa të vazhdueshme. Një nga arsyet për këtë supozohet se është fakti se në Shqipëri numri i kompanive farmaceutike kombëtare dhe ndërkombëtare është në rritje, të cilat kërkojnë të punësojnë farmacistët e diplomuar nga UKZKM.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës ndjek dhe përditëson bazën e të dhënave / regjistrin e të diplomuarve. Kjo zyre referon se 97% e tyre janë të punësuar prej të cileve 18% punojnë jashtë vendit (evidenca 92, dokumenti nr. 18).</p> <p>IAL ka komunikuar me Urdhrin e Farmacistëve ku ka kuptuar se</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>ky i fundit ka një total prej 2,839 (https://www.ufsh.org.al/membership/pharmacist) farmacistësh, të regjistruar në Shqipëri. GVJ-se po ashtu ju është bere me dije një studim i kryer nga Eurostat në vitin 2018 (http://www.scan-tv.com/ka-mjaftueshem-farmacine-Shqiperi-58-5-per-100-mjebanore-te-tretet-nga-fundi-ne-europe/) ku konkludohet se Shqipëria ka ende nevojë për farmaciste (në vitin 2018 kishte afërsisht 1679 farmaci, por 43% e tyre ndodhen në Tiranë dhe ka një mungesë të barnave në zonat rurale).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ vëren se objektivat specifike arsimore të programit të studimit arrihen nëpërmjet aktiviteteve bazë, aktiviteteve karakterizuese, aktivitete trajnuese atyre të ngjashme dhe plotësuese të biologjisë dhe mjekësisë (evidenca 93, dokumenti nr. 21). Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit, duke përfshirë edhe praktiken profesionale si dhe metodat e vlerësimit të studentit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. I diplomuari në programin e studimeve, me marrjen e diplomës dhe licencës për ushtrimin e profesionit përkatës, ushtron profesionin e farmacistit.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Struktura mësimore e programit është e njëjtë me programin e studimit në Universitetin e Barit, me të cilën IAL ka pasur një marrëveshje bashkëpunimi didaktike që nga viti 2014 (evidenca 93, dokument 21). Ky harmonizim ka çuar në akreditim, nga MIUR dhe ANVUR (evidenca 94, dokument nr. 22), programin e studimit në Farmaci si një program studimi ndëruniversitar ndërmjet UniBa dhe UKZKM ku titulli akademik ka vlefshmeri në të gjitha vendet e BE-së. GVJ konfirmon se programi është i organizuar në lëndë të cilat korrespondojnë me kreditet formuese në bazë të Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Përfshirë në strukturën didaktike është edhe praktika profesionale “si një veprimtari formuese kurrikulare” që parashikon përfitimin e krediteve formuese ECTS. Praktika profesionale përfshin një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh në një farmaci të hapur për publikun, ose në një spital nën mbikëqyrjen e shërbimit farmaceutik, për jo më pak se 30 ECTS.</p>





	(evidenca 95, dokumenti nr.23).
Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	GVJ konfirmon se programi i studimit hartohet në përputhje me direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluar dhe me sistemin e Bolonjës.
Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	GVJ konfirmon se praktika profesionale është pjesë e programit. Kjo zbatohet në përputhje me Direktivat përkatëse europiane dhe me bazën ligjore për profesionet e rregulluara në vend. Programi i studimit përcakton kërkesa minimale për të kryer praktikën (studenti të ketë marrë të paktën 130 ECTS, të ketë kaluar dy provime karakterizuese - Kiminë Farmaceutike dhe Toksikologjike dhe një të Farmakologjisë – dhe të demonstrojnë (me nënshkrim) frekuentimin në një lëndë të Teknologjisë Farmaceutike. Këto kërkesa bëjnë të mundshme që studentit të ketë njohuri themelore para se të vijojë praktikën profesionale, gjë që favorizon formimin e njohurive dhe aftësive gjatë praktikës. Neni 2 i "Rregullores së Praktikës-Profesionale" (evidenca 95, dokumenti nr.23) cakton kohëzgjatjen e praktikës (6 muaj me kohë të plotë dhe një total prej 750 orësh). Rregullorja po ashtu përcakton se praktika duhet të kryhet për të paktën tre muaj me kohë të plotë në Itali dhe për të paktën 1 muaj me kohë të plotë në Shqipëri. Ndërsa vendi ku do të kryhen dy muajt e mbetur mund të vendoset nga studentit (dhe të aprovet nga Koordinatorët e programit të studimit në Farmaci të UKZKM dhe UniBA). Për praktikën profesionale, IAL përdor marrëveshjet e përcaktuara me Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë (evidenca 96, dokumenti nr. 24) dhe UniBa të marrëveshjes së nënshkruar me Urdhrin e Farmacistëve të Rajonit të Puljes (evidenca 97, dokumenti nr. 25).
Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies,	GVJ konfirmon se programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në Farmaci i ofruar nga FF/UKZKM zhvillohet i tëri në gjuhën italiane. Përveç kësaj, bibliografia është e pasur dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	përveç teksteve në gjuhën italiane, studentët mund të konsultohen edhe me tekste në gjuhën angleze, lehtësisht të aksesueshme në bibliotekën e UKZKM.			
Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Në bazë të evidencave në dispozicion të GVJ, i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për mbarëvajtjen e Fakultetit të Farmacisë ruhet dhe arkivohet në zyrën e Koordinatorit dhe në Sekretarinë Mësimore. Meqenëse gjuhët që operon ky universitet janë gjuha shqipe dhe ajo italiane, të gjitha dokumentet arkivohen në këto dy gjuhë në zyrat e tyre përkatëse të kompetencës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4


Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë	<p>GVJ konstaton se institucioni ka përvojë të gjatë 17 vjecare në ofrimin e programeve të studimit në fushën e Mjekësisë dhe Infermierisë (liçensuar me VKM Nr. 567, datë 27.08.2004 dhe riorganizuar me VKM nr. 670 datë 28.09.2011). UKZKM është akredituar në vitin 2009 dhe riakredituar në vitin 2017 me vendim të BA nr.112, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje normale 6 vite akademike.</p> <p>Referuar dok Tabelat Përmbledhëse, tabela nr.1, për vitin akademik 2020 – 2021 Fakulteti i Farmacisë ka në përbërje 37 staf akademik gjithsej, nga të cilët 26 janë staf akademik efektiv (12 staf nga UKZKM dhe 14 staf nga UniBA), dhe 11 staf akademik me kontratë, të gjithë të UKZKM.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	Farmacisë në UKZKM. GVJ konstaton se IAL e ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën e farmacisë për ofrimin programit në fjalë. Stafit akademik është me grada/tituj relevant për ofrimin e programit (evidenca 102, dokumenti nr. 30; evidenca 103, dokumenti nr. 31; evidenca 125, dokumenti nr. 68).			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti i Farmacisë në total ofron 2 programe studimi: <ol style="list-style-type: none"> 1. Master i Shkencave (program i integruar) në Farmaci; 2. Dr.Shëndet Publik, Diagnozë Molekulare e Sëmundjeve Infektive dhe Farmakovigilancë; GVJ konfirmon se Fakulteti i Farmacisë si përgjegjës për programin e studimit përfshin staf akademik (të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin) me aktivitete kërkimore që janë direkt relevante me fushën e programit të studimit, p.sh.: të disiplinës së Farmakologjisë (BIO / 14), Kimisë Organike (CHIM / 06), Kimisë Farmaceutike (CHIM / 08), Patologjisë së Përgjithshme (MED / 04), Mikrobiologjisë (MED / 07) etj. (evidenca 125, dokumenti nr. 68).			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL, duke përdorur një sistem të informatikës, mundëson që stafi rregullisht bën shkëmbimin, përditësimin dhe ndarjen e punës dhe informacionit. Ky sistem lehtëson bashkëpunimin dhe organizimin e punës, jo vetëm me stafin akademik dhe administrativ, por edhe me stafin e universitetit partner, sipas dok. “Rregullorja për përdorimin e pajisjeve informatike”.</p> <p>Përparësi e madhe e këtij sistemi është jo vetëm bashkëpunimi dhe organizimi i punës brenda IAL, por edhe bashkëpunimi me stafin e universitetit partner. Kjo demonstroi qartë si institucioni siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Përveç marrëveshjes së ngushtë me UniBa, GVJ vlerëson se institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me aktorë të tjerë të rëndësishëm të sektorit farmaceutik sikurse me Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë (evidenca 96, Dokumenti nr. 24) dhe Urdhrin e Farmacistëve të Rajonit të Puljes (evidenca 97, Dokumenti nr. 25).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstaton se duke u bazuar në bashkëpunimin e ngushtë mes UKZKM dhe UniBa (evidenca 81, Dokumenti nr. 5), ky program studimi arrin të përmbushet me sukses, si nga ana teorike ashtu edhe praktike. Po ashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës krijon marrëdhënie me Organe/Institucione për mbledhjen e informacioneve për të inkuadruar diplomuarit në tregun e punës. GVJ është e mendimit se ky kriter përmbushet plotësisht.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës</p>	<p>Për të kryer praktikën profesionale, UKZKM përdor marrëveshjet e përcaktuara me Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë (evidenca 96, Dokumenti nr. 24) dhe UniBa të marrëveshjes së nënshkruar me Urdhrin e Farmacistëve të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

specifike të programit të studimit që ofron.	Rajonit të Puljes (evidenca 97, Dokumenti nr. 25).			
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore-shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	<p>GVJ konfirmon se institucioni ka bashkëpunim të afërt me UniBa si institut kërkimor-shkencor dhe një nga qëllimet e këtij bashkëpunimi është realizimi i kërkimeve shkencore.</p> <p>Megjithatë GVJ vëren se bashkëpunimi me institucione homologe apo institute kërkimore-shkencore (përveç UniBa) është i limituar dhe IAL duhet të punojë në këtë drejtim në mënyrë që të çojë në rritje të kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p> <p>Në këtë aspekt, bazuar në RVB dhe nga takimet në institucion GVJ vëren se megjithëse studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni për programet e mobilitetit, rezulton se nuk ka asnjë pjesëmarrje nga ana e studentëve në këto programe.</p> <p><i>GVJ sugjeron se Fakulteti i Farmacisë duhet të zbatojë politika më nxitëse dhe lehtësuese, në këtë drejtim për rekrutimin e studentëve në programet e mobilitetit.</i></p>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit janë të qarta, por GVJ nuk kishte evidencë të hartimit të raporteve analitike të përfitimeve nga këto marrëveshje të bashkëpunimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një	GVJ konstaton se ekziston evidencë se institucioni ndjek një

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. UKZKM themeloi <i>Komitetin Shkencor dhe Bordin Editorial</i> të revistës shkencore me Dekretin e Rektorit Nr. 407 (evidenca 104, Dokument nr. 44).			
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	EVOLUTION – <i>Journal of Life Sciences and Society</i> (https://www.unizkm.al/posts/slug/publications/) është revistë e botuar në formatin elektronik dhe të shtypur dhe është kushtuar Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale të IAL. Kjo revistë pershin studimet e stafit akademik dhe studiuesve shkencorë të IAL. Në vitin 2018, IAL gjithashtu botoi Pontes (evidenca 105, Dokumenti nr. 46 ;			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	https://www.unizkm.al/posts/slug/rivista-pontes-descrizione/?highlight=pontes).			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimorebotuese.	Mirëpo, GVJ vëren se përveç metodave të sipërpërmendura, politika mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor është e dobët. Nuk kishte evidencë se ekziston njësi institucionale që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor si dhe kryen analizën e kërkimit shkencor. Ndër dokumentat e ngarkuar nga IAL për akreditimin e programit “Master Shkencor” në “Farmaci”, <i>GVJ nuk ka në dispozicion evidencë se IAL</i> ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Po ashtu, nuk evidentohet në shkallë të lartë se universiteti përkrah studentët dhe kërkuesit e rinj të ndërmarrin iniciativa personale në fushën përkatëse. Kjo vërtetohet me numrin e vogël të studentëve që zgjedhin temë eksperimentale të diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit është i hartuar bazuar në dispozitat ligjore përsa i përket organizimit të tij. Për çdo lëndë janë të përcaktuara kreditet përkatëse, të cilat ndahen në varësi të formave të realizimit të tyre. Ky program është hapur me Vendimin Nr. 567, datë 27/08/2004 (evidenca 77, dokumenti nr. 1), si një program i përbashkët ndërmjet UKZKM dhe UniBa, me një kohëzgjatje prej pesë vitesh, i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite dhe parashikon përfitim të 300 ECTS në total (evidenca 106, dokumenti nr. 47). Kurrikula e këtij programi është në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (CFU), me një total prej 300 kreditesh arsimore.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Referuar RVB dhe rregullores së programit të studimit, programi në katër vitet e para fokusohet në veprimtaritë bazë të formimit, ato karakterizuese dhe të lidhura ose plotësuese, si dhe veprimtari të tjera trajnuese dhe marrjen e njohurive të mëtejshme përmes zgjedhjes së pavarur të aktiviteteve të formimit (evidenca 93, Dokument nr. 21). Programi po ashtu inkorporon një periudhë për praktikën profesionale “si një veprimtari formuese kurrikulare” dhe ky aspekt i programit është shumë i rëndësishëm pasi ju siguron të diplomuarve formim profesional praktik. Po ashtu, tema përfundimtare, e cila është mundësi për zhvillim të njohurive apo aftësive specifike të avancuara parashikon përfitim të krediteve të formimit.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ai synon pajisjen me njohuritë bazë dhe ka përmbytje të tillë që t’u ofrojë studentëve njohuritë bazë dhe të avancuara.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Duke u bazur në evidencë dhe takime me stafin e IAL, është e qartë se objektivi kyç i programit është të pajisë të diplomuarit me bazat shkencore dhe përgatitjen teorike dhe praktike të nevojshme për të ushtruar profesionin e farmacistit dhe për të operuar si ekspert i barnave dhe produkteve shëndetësore në të gjitha fushat ku kërkohen këto njohuri. Programi përmban komponentë (p.sh.: tema e diplomës dhe praktika profesionale) të cilat përgatisin të diplomuarit për zgjidhjen e problemeve komplekse në ushtrimin e detyrës profesionale.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit ka të gjithë elementët që parashikon legjislacioni në fuqi (VKM Nr. 41, dt 24.01.2018), për sa i përket strukturës së tij. Në dosjen e programit të studimit është paraqitur plani mësimor, ku çdo lëndë ka të përcaktuara kreditet dhe kategorizimin sipas kodeve përkatëse, formën e veprimtarive formuese (leksione, seminare, praktika) të përcaktuara me kreditet respektive, syllabuset e lëndëve të cilat përmbanin veprimtaritë dhe objektivat formues, kontrollin e dijeve dhe mënyrën e vlerësimit. Në përfundim të studimeve studentët marrin një diplomë në përputhje me parashikimet ligjore. Stafi akademik përbëhet nga pedagogë me titullin profesor, kërkues shkencorë dhe pedagogë me titullin PhD.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite (evidenca 93, dokumenti nr.21).</p> <p>Sipas dokumentit <i>Tabela përmbledhëse 1, tabela nr. 9</i>, programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A: Lëndë bazë 15 % -20 % të krediteve; - Kategoria B: Lëndë karakterizuese 50 % -55 % të krediteve; - Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 12 % -15 % të krediteve; - Kategoria D: Lëndë plotësuese 10 % - 15 % të krediteve; - Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 3 % -5 % të krediteve;
<p>Kriteri 7. Programi i integruar i</p>	<p>Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për</p>

studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj të detajuara në një Rregullore për Temën e Diplomës (evidenca 134, Dokumenti nr. 71).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore, e cila ofron programin e studimit është Fakulteti i Farmacisë. Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i tij janë të përcaktuara në statutin e Universitetit dhe janë në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Në përbërje të Fakultetit të Farmacisë janë 3 Departamente: <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Farmaceutike; 2. Departamenti i Teknologjive Kimiko – Farmaceutike dhe Biomolekulare; 3. Departamenti i Vlerësimit Kimik-Teknologjik dhe Farmakologjik të Barnave;
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, duke iu referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL duke respektuar ligjet në fuqi. Sipas nenit 25 të ligjit, departamenti përbëhet nga personel akademik shqiptar, të cilët emërohen me Urdhër të Rektorit dhe personel akademik Italian, të cilët konfirmohen nga Universiteti partner sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit (evidenca 108, dokumenti nr. 50).
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën	Referuar (evidenca 169, Tabelat përmbledhëse tabela nr. 1). shpërndarja e personelit akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021 është:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




akademike.	IAL	Fakulteti i Farmacisë, 2020-2021				
		PAE			PAK	
		UNIZKM	UniBA	Tituj/Grada	Tituj/Grada	Tot
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Departamenti i Shkencave Farmaceutike	4	4	(2) Prof. Dr (1) Prof. Assoc (5) Kerkues shkencor () Dr () Msc	(5) Prof. Dr () Dr () Msc	13
	Departamenti i Teknologjise Kimike-Farmaceutike dhe Biomolekulare	4	4	(2) Prof. Dr (4) Prof. Assoc (2) Kerkues shkencor () Dr () SPA () Msc	() Prof. Dr (3) Prof. Assoc () Dr () SPA () Msc	11
	Departamenti i Vlerësimit Kimik-Teknologjik dhe Farmakologjik të Barnave	4	6	(1) Prof. Dr (5) Prof. Assoc (4) Kerkues () Dr () Msc	(1) Prof. Dr (2) Prof. Assoc () Dr SPA () Msc	13
	Total	12	14		11	37

Mësimi kryhet nga pedagogë italianë dhe shqiptarë me kualifikim dhe përvojë adekuate (**evidenca 125, dokument nr. 68**). Stafi akademik i Fakultetit përbëhet nga anëtarë me kohë të plotë dhe profesorë me kontratë dhe kërkues shkencorë, sipas parashikimeve të legjislacionit dhe udhëzimeve të Ministrisë. Bashkëpunimi ndërmjet IAL dhe universitetit partner vërehet edhe gjatë realizimit të punimit të diplomës.

Për arritjen e qëllimeve pedagogjike, njësia kryesore/bazë angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj. P.sh.: përmendim kërkuesit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	shkencorë të cilët mund të angazhohen në ndjekjen e studentëve gjatë gjithë ciklit të programit të studimit.			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Detyrat e Koordinatorit janë të shtjelluara në evidencën nr. 53-Detyrat e Koordinatorit . Evidenca demonstroi se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin cakton një person në rolin e koordinorit. Ndër detyrat e tij, koordinatori ka orientimin e studentëve; harton kalendarin e mësimdhënies; merret me monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive mësimore; ka rolin e udhëheqësit akademik të pjesës së praktikës që kryhet në Shqipëri, si dhe mbledh mendimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor dhe ndërvepron me pedagogët për ndërhyrjet e nevojshme. Prandaj, studentët gjithmonë kanë një figurë udhëheqëse gjatë studimeve të tyre. Koordinatori kujdeset për informacione kyçe (p.sh.: Programin mësimor, kalendarin e provimeve, orarin e leksioneve dhe laboratorët) dhe këto informacione raportohen dhe dokumentohen.			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në bazë të evidencave të paraqitura në RVB, edhe pse jo gjithmonë të cituara në mënyrë adekuate, GVJ konstaton se Fakulteti i Farmacisë ka informacion të plotë për të gjitha veprimtaritë akademike në lidhje me zbatimin e planit mësimor për programin e studimit, ku përfshihen, përveç të tjerave, rregullorja e programit (evidenca 93, Dokument nr. 21), syllabusi (evidenca 112, Dokument nr. 54), plani i studimit (evidenca 106, Dokument nr. 47) dhe CV e pedagogëve (evidenca 125, Dokument nr. 68).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi integruar i studimit ka një kohëzgjatje prej 5 vjetësh, organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, dhe përfshin gjithsej 300 ECTS. Një orë e leksioneve, seminareve dhe laboratorëve korrespondon me 25 orë angazhim total. Programi përfundon me marrjen e ECTS-ve në kalimin e provimit përfundimtar. Mësimdhënia organizohet me bazë gjashtë mujore dhe përfshin lëndë teorike dhe praktike (ushtrime në klasë ose laborator).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Sipas të dhënave paraqitur në RVB (evidenca nr. 93, Dokumenti nr. 21), programi i formimit parashikon organizimin e veprimtarive formuese bazë, karakterizuese dhe të lidhura me to ose plotësuese të trajnimit, si dhe “Veprimtari të tjera formuese” dhe marrjen e njohurive të mëtejshme përmes zgjedhjes së pavarur të veprimtarive të formimit ndërmjet atyre të sugjeruara nga programi i studimit si dhe kryerjen e praktikës profesionale dhe përgatitjen e temës përfundimtare.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konfirmon se programi përmban planin mësimor (evidenca 106, Dokumenti nr. 47) i cili është i njëjtë në formë dhe në përmbajtje me atë të ofruar nga UniBa dhe përmban të gjitha informacionet në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe ato individuale etj.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon ekzistencën e rregulloreve për transferimin e studimeve në UKZKM të cilat përcaktojnë procedurat e transferimit për kandidatët shtetas shqiptarë dhe të huaj (evidenca 115, Dokumenti nr. 55). IAL posedon në strukturën e saj edhe Zyrën e Pranimeve që informon studentët për kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimet dhe transferimet. Ky informacion është po ashtu në dispozicion në faqen zyrtare të Universitetit: www.unizkm.al.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat,</p>	<p>Programi i studimit disponon syllabuset e të gjitha lëndëve që zhvillohen. Kryesisht ato kanë të dhënat e kërkuara nga dispozitat ligjore në fuqi mbi emërtimin, kategorizimin, kreditet, ndarjen dhe numrin e orëve të Leksioneve, Seminareve,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Laboratoreve, Paktikave si dhe mënyrën e kontrollit të dijeve (evidenca 112, Dokumenti nr. 54).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Në bazë të evidencave të paraqitura në DVB, GVJ nuk ka hasur në evidencë që demonstroi se përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe që në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale. GVJ vlerëson se <i>ky kriter nuk plotësohet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstaton se programi i integruar i studimit është strukturuar dhe ofrohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Institucioni shqyrton disponueshmërinë e stafit akademik, teknik dhe administrativ, si dhe infrastrukturën, në mënyrë që të mundësohet realizimi i programit të studimit dhe të ketë një ecure normale të procesit mësimor.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Duke u bazuar në evidencën në dispozicion, është e qartë se përmbajtja dhe organizimi i programit, i cili përputhet me të njëjtin program të integruar studimi të UniBa, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. Kreditet (ECTS) janë njësia matëse e punës së bërë nga studenti për veprimtaritë mësimore. Në përputhje me <i>Kartën e Bolonjës</i> ,
Kriteri 3. Lëndët/modulet,	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>1 ECTS korrespondon me 25 orë të ndara në orë në auditor dhe orë individuale. Grumbullimi i krediteve bëhet me kryerjen e veprimtarive formuese duke kaluar provimet ose provat për kalueshmërinë.</p> <p>Lëndët/modulet, organizimi i tyre dhe vlerësimi mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Programi synon që formimi teorik dhe shkencor i studentëve t'u jap aftësinë për të punuar si ekspert i barnave në mënyrë të pavarur dhe kapacitetin për t'u thelluar në studime përmes një aktiviteti kërkimor shkencor të ciklit të III-të të studimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar "Master i shkencave" dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Raporti teori-praktikë si dhe raporti i aktiviteteve në universitet me studim individual është në përputhje me profilin e programit të integruar "Master i shkencave" dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare (në këtë rast e njëjtë me programin e UniBa). Raportet e veprimtarive arsimore përmbushin objektivat e programit të studimit dhe oferta e njëjtë arsimore me UniBa lehtëson zgjedhjen e studentëve për transferimin e studimeve dhe lëvizshmërinë e tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Fakulteti bashkëpunon me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ky bashkëpunimi bëhet me qëllim për të konsultuar dhe shqyrtuar propozime nga tregu i punës në mënyrë që të përshtatë procesin e trajnimit. Edhe pse nuk ka ndonjë rast konkret për përshtatjen e programit duke konsideruar kërkesat e tregut të punës, mekanizmat e nevojshme ekzistojnë. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet me titullarët e lëndëve të cilët njëkohësisht monitorojnë realizimin e lëndës/modulet në përputhje me syllabusin e miratuar, që kryesisht janë pedagogë italianë me ekspeicencë didaktike edhe në UniBa. Bazuar në sa më sipër GVJ konstaton se ky kriter përmbushet.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i ofron studentit njohuri dhe kuptim të shkencave të fizikës, kimisë biologjisë, biokimisë, anatomisë, fiziologjisë, patologjisë, farmakologjisë, toksikologjisë etj, që shërbejnë si bazë për të arritur një njohuri të thelluar të barnave, produkteve dietike dhe kozmetike dhe teknologjisë farmaceutike. Përveç</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	dijeve relevante, programi po ashtu garanton përfitimin e aftësive dhe kompetencave që i nevojiten një farmacisti kompetent.
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>GVJ konstaton se përmbajtja e programit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, edhe pse gjatë takimeve me stafin mësimor të programit janë cekur vetëm disa raste të studentëve, të cilët kanë vijuar studime të mëtejshme (PhD). Sa i përket mundësimit të punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, kjo është e qartë po të vërejmë përqindjen e studentëve që diplomohen ‘Master i Shkencave’ në Farmaci pranë UKZKM (Dokument nr. 18 - Raport për të diplomuarit dhe Analiza e tregut të punës për Farmacistët) se programi arrin këtë qëllim.</p> <p><i>GVJ vëren se përmbajtja e programit të integruar të studimit Farmaci të ofruar nga FF/UKZKM është e fokusuar drejt njohurive farmakologjike, klinike gjë që është në përputhje me tregun e punës në Shqipëri, ku industria farmaceutike nuk është shumë e zhvilluar dhe punëdhënësi më i madh në këtë fushë janë farmacitë e rrjetit të hapur apo distributorët farmaceutikë.</i></p>
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>Fakulteti bashkëpunon me Zyrën e Këshillimit të Karrierës për të konsultuar dhe shqyrtuar propozime nga tregu i punës në mënyrë që të përmirësojë dhe përshtatë procesin e trajnimit.</p> <p>Nga të dhënat në RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion rezulton se kjo zyrë është një interlokutore shumë e mirë midis UFSH, farmacive të rrjetit të hapur, distributorëve farmaceutikë nga njëra anë dhe studentëve që diplomohen, nga ana tjetër me qëllim punësimin e këtyre të fundit.</p>
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	<p>Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor dhe kohëzgjatja e programit prej 5 vitesh, mundëson njohuri të avancuar. Sa i përket përgatitjes së studentëve për kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve, evidenca është e limituar, sepse numri i të diplomuarve që kanë vijuar këto studime është i vogël. Gjatë takimeve me përfaqësues të IAL, <i>GVJ vëren se një proporcion tejet i madh i studentëve për temë diplome zgjedhin temë bibliografike e jo eksperimentale, ku kjo e fundit do të kishte</i></p>

	<i>kontribut shumë më të madh në përgatitjen e studentëve për kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit me kohë të plotë apo të pjesshme plotësojnë kërkesat e vendosura nga legjislacioni në fuqi. Stafi i universitetit partner që punon me kohë të plotë (Evidenca 108, Dokument nr. 50) për këtë program studimi konfirmohet çdo vit nga Dekani i Fakultetit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

GVJ konfirmon se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për realizimin e programit të studimit (**evidenca 125, dokumenti nr. 68**). Stafit akademik me kohë të plotë së bashku me stafin akademik të Universitetit partner zhvillon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore. Personeli akademik i angazhuar për realizimin e këtij programi studimi për vitin akademik **2020 – 2021** përbëhet nga **37 pedagogë gjithsej**, prej të cilëve 26 pedagogë me kohë të plotë (PAE) dhe 11 pedagogë me kohë të pjesshme (me kontratë). **Raporti PAE / PAK, 70.2% / 29.7%**.

Balanci i stafit përsa i përket senioritetit apo përvojës është adekuat: 11 pedagogë kanë titullin "Profesor" (29.7% të stafit akademik), 14 pedagogë kanë titullin "Profesor i Asociuar" (38% të stafit akademik), 11 pedagogë kanë titullin PhD "Kërkues Shkencor" (29.7% të stafit akademik).

Nga shqyrtimi i (**Evidenca 169, Tabelat përmbledhëse**) numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi në 6 vite akademike është si më poshtë:

Gradat/Titujt/	2020-2021		2019-2020		2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	4	7	4	7	4	6
Prof.Assoc	11	3	10	4	7	5
Dr/PhD	9	1	11	1	10	1
Kërkues shkencor	4	-	4	-	6	-
SPA	-	-	-	-	-	-
MSc	-	-	-	-	-	1
	28	11	29	12	27	13
Total	39		41		40	

Gradat/ Titujt/ Kualifikimet	2017-2018		2016-2017		2015-2016	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK

Prof.Dr	5	6	6	5	5	6
Prof.Assoc	8	4	7	4	13	3
Dr/PhD	13	1	19	2	20	4
Kërkues shkencor	13	-	6	-	6	-
SPA	-	-	-	-	-	-
MSc	4	1	2	1	2	-
	43	12	40	12	46	13
Total	55		52		59	

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoti se fusha akademike e personelit të angazhuar ishte në përputhje me lëndët/modulet specifike që ata mbulonin në kuadër të programit të studimit

I gjithë stafi mësimor i përfshirë në mësimdhënie përbëhet nga pedagogë fusha e kërkimit akademik dhe shkencor e të cilëve është ajo e mësimdhënies.

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike

GVJ konstaton se për realizimin e praktikës IAL ka në dispozicion personel të mjaftueshëm, dhe të kualifikuar në nivel adekuat. E njëjta gjë vlen edhe për punimin e temës së diplomës, mirëpo siç është cekur më lart, *studentët duhet të suportohen dhe t'ju mundësohet që në diplomim të zgjedhin më shumë tema eksperimentale.* Praktika konsiston në pjesëmarrjen e asistuar dhe të verifikuar të studentit në aktivitetet e farmacisë pritëse në lidhje me qëllimet e vetë praktikës (**evidenca 109, Dokument nr. 51**). Marrëdhëniet me ta rregullohen nga marrëveshje specifike bashkëpunimi në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

sipas natyrës së programit të studimit.	përputhje me Nenin 1, paragrafi 2 i Rregullores së Praktikës (evidenca 95, Dokumenti nr.23). Studentët informohen (nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Farmacisë dhe Koordinatori i programit) për kërkesat që duhet të plotësohen para fillimit të praktikës dhe rreth dokumentacionit perkates. E njëjta procedurë kryhet edhe për Rregulloren e temës së diplomës, sipas së cilës, për përgatitjen e saj, studenti i diplomuar duhet të ndihmohet nga një Udhëheqës dhe një Bashkë-Udhëheqës.			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Nga të dhënat e RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion mund të thuhet se FF ka angazhuar personel ndihmës-mësimorshkencor në përputhje me numrin e laboratorëve dhe sasinë e orëve mësimore që zhvillohen në to. Ky personel mbështet realizimin e orëve laboratorike si dhe mirëmban laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Duke u bazuar në RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se Zyra e Këshillimit të Karrierës bashkëpunon me institucione publike dhe private me të cilat universiteti ka një marrëveshje bashkëpunimi. Ky bashkëpunim shërben për të kuptuar nevojat dhe kërkesat profesionale të tregut. <i>Mirëpo, nuk është evidentuar tek GVJ se si këto informacione integrohen në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Institucioni inkurajon	Sipas RVB- se, institucioni përkrah dhe përfshin studentët të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në takimet e organizuara nga Koordinatori dhe nëse konsiderohet e nevojshme përfshihet edhe Dekani i Fakultetit të Farmacisë në këto takime. Mirëpo,</p> <p><i>GVJ konstaton se proceset formale për inkurajimin dhe përfshirjen e studentëve dhe strukturave të tyre në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit duhet të përmirësohen.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Sipas evidencës, Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit dhe merr propozime prej tyre sa i përket përmirësimit të programit të studimeve (https://www.unizkm.al/posts/slug/alumni-reunion-2019).</p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.</p>	<p>RVJ thekson se ‘marrëveshjet e bashkëpunimit të përcaktuara me organizata të ndryshme dhe aktivitetet e vazhdueshme të organizuara së bashku, krijojnë lehtësira dhe mbështetje për përditësimin, përfundimin dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies, trajnimit dhe kërkimit, duke ofruar kurse që janë plotësisht në përputhje me politikat e formimit të të rinjve dhe e arsimit të vazhdueshëm në vend dhe në rajon.’</p>			
<p>Kriteri 5. Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme</p>	<p>Megjithëse evidenca për organizimin e programeve të posaçme me fushë specifike studimi ekziston (evidenca 91, Dokument nr. 17), nuk është e qartë se si institucioni përditëson programin aktual “Master i Shkencave në Farmaci” duke u bazuar në ndërveprime me aktorët relevant vendor, edhe pse kuptohet që marrëveshja dhe programi i njëjtë me universitetin partner krijon vështirësi në këtë aspekt.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.7

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranç gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat e tij, në lidhje me formimin e përgjithshëm teorik, aftësimin praktik dhe krijimin e bazave për thellimin në studime të mëtjeshme akademike apo kërkimin shkencor. Objektivat specifike të programit të studimit janë ofrimi i një sërë njohurish teorike dhe praktike, si dhe aftësive relevante, për studentët, në ushtrimin e detyrës së farmacistit. Programi po ashtu ofron bazën metodologjike të analizimit shkencor. Njohuritë e shkencave themelore janë të integruara me ato të farmakoekonomisë, farmakovigjilencës dhe me legjislacionet kombëtare që rregullojnë aktivitetet e ndryshme të sektorit. Programi pra synon formimin e një figure profesionale të ekspertit mbi barnat dhe përdorimin e tyre për qëllime terapeutike, ku ky ekspert ka përgatitjen adekuate, jo vetëm në aspektin shkencor dhe teorik, por edhe praktik dhe aftësi për të aplikuar njohuritë shkencore, si p.sh.: komunikimi me pacientët ku ky komunikim ju përshtatet nivelit të të kuptuarit të pacientit. Prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit gjenden edhe në faqen hyrëse të programit online.</p> <p>https://www.unizkm.al/study/faculty/facolta-di-farmacia/al</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nisur nga vizita në institucion si dhe të dhënat që përmban DVV GVJ vëren se në FF/UKZKM, njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën farmaceutike të studimit.</p> <p>Njësitë bazë (departamentet) janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit akademik mësimor. Ato ndiqnin nga afër zhvillimin dhe realizimin e lëndëve, kanë gjithmonë kontakte me personelin akademik, adresonin problematika të ndryshme të studentëve si dhe koordinonin veprimtaritë kërkimore të personelit mësimdhënës. <i>GVJ vlerëson se ky kriter plotësohet.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter nuk përmbushet plotësisht.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Megjithëse IAL ka evidentuar përfshirjen e studentëve të programit në seminare dhe konferenca të ndryshme (https://www.unizkm.al/events/prevenzione-dei-difetti-congeniti-in-albania-stato-dellarte-e-prospettive-future; https://www.unizkm.al/events/politiche-e-pratiche-sulluso-degli-antibiotici-nellambito-ospedaliero-in-albania-1; https://www.unizkm.al/events/dalla-biologia-strutturale-alla-chemio-informatica-approcci-innovativi-per-nuove-strategie-terapeutiche-1; https://www.unikzkm.al/events/ruoli-fisiopatologici-del-solfuro-al-livello-cardiovascolare; https://unizkm.al/events/settore-farmaceutico-in-albania-situazione-attuale-e-prospettive-future; https://unizkm.al/events/albania-ed-italia-a-confronto-aspetti-microbiologici-ed-epidemiologici-delle-patologie-infettive-emergenti-e-riemergenti; https://www.unizkm.al/events/il-percorso-della-sanita-albanese/en; https://www.unizkm.al/news/il-futuro-della-pandemia-covid-19; Rregullore për shpërndarjen e kontributeve për Kërkimin Shkencor në Universitetin KZKM, duke u bazuar në RVB dhe takimet me IAL, është e qartë se programi duhet të bëjë më shumë në mënyrë që të nxisë dhe motivojë studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Kjo mund të adresohet, përveç metodave të tjera, me rritjen e numrit të studentëve që zgjedhin temën eksperimentale të diplomës.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Mund të thuhet se bazuar në RVB Programi i studimit i ofruar nga UKZKM përfshin edhe hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Duke u bazuar në evidencë (RVB dhe takimet në IAL), GVJ konstaton se Fakulteti i Farmacisë mbështetet financiarisht nga institucioni për realizimin e veprimtarisë kërkimore dhe shkencore. Me propozim nga Senati Akademik dhe miratim nga Këshilli i Administrimit, institucioni siguron një fond vjetor për zbatimin e veprimtarive mësimore dhe mbështet kërkimin shkencor (evidenca 121, Dokument nr.62).</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Referuar RVB-së, konstatohet se Zyra e Projekteve Kërkimore dhe Formuese informon dhe përditëson strukturat e Universitetit mbi programet e ndryshme dhe thirrjet për projekte kërkimore (evidenca 122, Dokument nr. 63) dhe formuese (të financuara nga burimet e ndryshme, p.sh.: Universiteti, në nivel kombëtar, evropian etj.), dhe mbi mënyrat përkatëse të pjesëmarrjes.</p> <p>Kjo Zyrë, po ashtu ndihmon në përgatitjen, prezantimin, menaxhimin, monitorimin, zbatimin, raportimin dhe shpërndarjen e këtyre projekteve. IAL po ashtu siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor falë rrjeteve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimeve institucionale dhe kontakteve dhe rrjeteve të Universitetit partner.</p> <p>(https://www.unizkm.al/categories/projects/posts) (https://www.unizkm.al/categories/agreements-and-networks/posts)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL mbështet departamentet dhe Fakultetin, përmes financimit vjetor të projekteve kërkimore. Realizimi i temave eksperimentale në laboratorë kërkimorë bën të mundur përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore që udhëhiqen nga stafi akademik i programit të studimit. Mirëpo, siç është cekur edhe më herët, një proporcion i vogël i studentëve është i angazhuar në realizimin e temave eksperimentale dhe IAL ka hapësirë përmirësimi në këtë aspekt.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për</p>	<p>Sipas evidencës, GVJ konfirmon se në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Këto aktivitete organizohen në nivel departamenti</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

arritjen e objektivave	<p>dhe në nivel institucional dhe duke bazuar në bashkëpunime të ndryshme. Këto aktivitete përfshijnë konferenca shkencore, seminare dhe leksione të hapura duke përfshirë stafin akademik dhe studentët.</p> <p>https://unizkm.al/events/albania-cd-italia-a-confronto-aspetti-microbiologici-ed-epidemiologici-delle-patologie-infettive-emergenti-e-riemergenti; https://www.unizkm.al/events/il-percorso-della-sanita-albanese/en https://www.unizkm.al/neës/il-futuro-della-pandemia-covid-19</p> <p>https://unizkm.al/neës/limportanza-dellacido-folico-nella-prevenzione-dei-difetti-del-tubo-neurale ;</p> <p>https://www.unizkm.al/events/uso-degli-antibiotici-nellera-del-covid-19-presente-e-futuro.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve,	RVB thekson se ‘fakulteti organizon takime dhe diskutime ndërmjet pedagogëve që janë planifikuar gjatë vitit akademik në mënyrë që të identifikohen metodologjitë gjithnjë e më të përshtatshme dhe inovative për secilën lëndë për ta bërë mësimin e studentëve më efektiv’ si dhe ‘programi i studimit synon

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




lëndëve/moduleve.	<p>gjithashtu të përdorë metoda inovative për tema specifike për secilën lëndë.’</p> <p><i>Mirëpo, GVJ nuk hasi në evidencë se IAL harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, përpos mësimit online të zhvilluar gjatë periudhës së pandemisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në deklaratimet gjatë vizitës në institucion u vërejt se IAL përdor si formë kryesore për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive të mësimdhënies të personelit akademik dhe ndihmës akademik, atë të marrë nga studentët si për mësimdhënien, ashtu edhe për stafin akademik. Studentët përfshihen në këtë proces vlerësimit duke shprehur perceptimet e tyre në lidhje me aktivitetin akademik dhe organizimin logjistik të programit të studimit nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar që plotësohen në mënyrë elektronike (evidenca 123, Dokumenti nr. 66). Përgjegjës për këtë aktivitet është Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Statistikave. Më pas rezultatet e përpunimit statistikor të këtyre pyetësorëve përcillen në bordet drejtuese.</p> <p>Gjatë takimit në institucion GVJ u interesua nëse përdorej vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik nga kolegët dhe nuk mori përgjigje specifike pohuese në këtë pyetje. Aplikohet vetëm një formular vetëvlerësimi nga ana e pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Siç është cekur më lart, GVJ konfirmon se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit. Marrja e mendimeve të studentëve për mësimdhënien dhe vlerësimin e dijeve bëhet jo vetëm nëpërmjet pyetësorëve, por edhe përmes takimeve mujore me studentët, të organizuara nga Koordinatori i Programit, të cilat zhvillohen me studentët e të gjitha viteve. Gjithashtu zhvillohet edhe një takim vjetor me përfaqësues të studentëve ku merr pjesë si Koordinatori ashtu edhe pedagogët e Dekani i FF. Pedagogët bëjnë monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të marra përpara i përket performancës dhe efektivitetit të të nxëniet nga studentët dhe mund të propozohen mënyra dhe</p>

	metodologji inovative duke u bazuar në këtë monitorim.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Bazuar ne evidence, nga Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, Rektorit dhe Zyrave përkatëse i paraqitet çdo vit një raport mbi rezultatet e shprehura nga studentët përsa i përket cilësisë së mësimdhënies (evidenca 214, Dokument nr. 67). Kjo strukturë i paraqet Rektorit dhe Senatit Akademik një raport vjetor mbi didaktikën, kërkimin shkencor dhe shërbimet e kryera nga Universiteti, si dhe mbi nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga njësitë e ndryshme organizative. <i>GVJ nuk pati evidencë në dispozicion se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit, p.sh.: përmes publikimit në faqen e internetit.</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	GVJ konstaton se megjithëse IAL ka mekanizma për vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik, <i>nuk është e qartë se si implementohen këto vlerësime në mënyrë që të përmirësohet më tej mësimdhënia. Po ashtu nuk ka evidencë se IAL ofron trajnime më të thelluara/intensive të stafit në fushë të pedagogjisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike,	Bazuar në RVB si dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve përfshijnë si leksione teorike (në auditor), ashtu edhe leksione me qëllime praktike (ushtrime në klasë ose në laborator), kohë e përkushtuar për hartimin e projekteve dhe aktiviteteve praktike (praktikat e kryera brenda kompanive

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>dhe/ose organizatave të ndryshme nga universitetet) dhe studimin vetjak të studentit. Kjo është detajuar në planin mësimor (evidenca 93, Dokument nr. 2). RVB nuk komenton për detyra të kursit në mënyrë adekuate, mirëpo duke u bazuar në diskutimet gjatë takimeve në IAL, rezulton se ky aktivitet përfshihet në format e mësimdhënies/vlerësimit të studentëve. <i>Në këtë kuadër GVJ konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Sipas, RVB 'stafi akademik u përgjigjet kërkesave të studentëve, duke ofruar mënyra dhe metoda alternative të të nxënit dhe përmirësimit në fushën e mësimdhënies', mirëpo kjo deklaratë nuk është mbështetur me evidencë adekuate.</p> <p>Megjithatë bazuar në gjetjet gjatë takimeve në institucion GVJ është i mendimit se ky standard plotësohet, nëse i referohemi zhvillimit të kurseve të gjuhës italiane që iu ofrohen studentëve për të patur një komunikim sa më korrekt me pedagogët italianë që inicohen sigurisht sipas nevojave të studentëve apo metodave alternative të mësimdhënies të ndjekura nga institucioni gjatë pandemisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Megjithëse ka evidencë se institucioni mbështet stafin akademik për të përdorur metodologji të reja që i ndihmojnë studentët të përmirësojnë përvetësimin e aftësive të reja (p.sh.: zyra e IT në mënyrë periodike ofron kurse formimi dhe ofron ndihmë teknike për pedagogët), nuk është evidentuar apo komunikuar një mbështetje në nivel më të lartë (p.sh.: kurse intensive të pedagogjisë për stafin e ri).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ është e mendimit se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie (nga UKZKM si dhe universiteti partner UniBA) është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve dhe kjo mund të vërtetohet (deri në një shkallë) përmes karrierës së tyre akademike (evidenca 125, Dokumenti nr. 68).</p> <p>Po ashtu perceptimi i studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies (evidenca 214, Dokumenti nr 67) konfirmon</p>




	aftësitë/kompetencën e stafit akademik në mësimdhënie.			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ konfirmon se ka disa iniciativa nga IAL për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, ku studentët përfshihen në këtë proces: çdo fillim viti akademik, koordinatori përcjell shqetësimet dhe sugjerimet e studentëve tek stafi akademik. Përpos kësaj koordinatori zhvillon dëgjesa të përmuajshme me studentët e kur është e nevojshme, e kërkuar nga studentët edhe më shpesh. Kontaktet dhe shkëmbimet me studentët janë të vazhdueshme si në auditore, ashtu edhe nëpërmjet Këshillit Studentor dhe kjo ndihmon në ecurinë pozitive dhe përmirësimin e mënyrës së transmetimit të njohurive.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	GVJ vëren se, bazuar në RVB dhe bashkëbisedimin me studentët gjatë takimit në institucion, gjatë leksioneve, ushtrimeve, seminareve dhe laboratorëve, pedagogët shpeshherë janë ndërveprues me studentët, mësimi zhvillohet në mënyrë interaktive. Për rrjedhojë GVJ shprehet se ky kriter përmbushet plotësisht.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Duke u bazuar në evidencë, posaçërisht diskutime me studentët, GVJ është e mendimit se format dhe metodat e mësimdhënies, inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit dhe sigurojnë mbështetjen e studentit. Një shembull i mirë i mbështetjes së studentëve është përfshirja e orëve ekstra-kurrikulare të gjuhës italiane (për t'i ndihmuar studentët me gjuhën) dhe Laboratori i shkrimit akademik me në total 210 orë. Gjithashtu format dhe metodat e mësimdhënies të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset përkatëse synojnë përgatitjen e një farmacisti të ardhshëm jo vetëm me aftësi profesionale, por edhe pavarësi mendimi e veprimi që e përfshijnë atë në vendimmarrje dhe gjykimet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion GVJ vëren se për realizimin e procesit mësimor, fakulteti ka në dispozicion ambiente të ndryshme. Ambientet ku zhvillohet mësimi kanë hapësirën dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e tij në kushte normale. Brenda Kampusit Universitar, i cili ka një sipërfaqe prej 50,000 m ² , ka ndërtesa të strukturave të ndryshme dhe disa zona për kryerjen e veprimtarive arsimore, kërkimore dhe rekreative. Universiteti vë në dispozicion të studentëve klasa, laboratorë, bibliotekën, por edhe hapësira të tjera të përbashkëta. Të gjitha ambientet ku kryhet procesi mësimor dhe shkencor pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht sipas udhëzimeve të Ministrisë. <i>GVJ vlerëson se ky kriter përmbushet.</i>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Duke u bazuar në evidencë dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion, ambientet e dedikuara për procesin mësimor ishin funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, me kompjutera, sistem wi-fi si dhe pajisje laboratorike cilësore që mundësojnë zhvillimin e teorisë dhe praktikës në mënyrë cilësore dhe plotësojnë nevojat e studentëve.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	GVJ konstaton se Institucioni ka investuar në teknologji moderne për mësimdhënien dhe për punën kërkimore. Të gjitha klasat ku kryhet procesi mësimor janë funksionale dhe të pajisura me PC; video projektor, sistem IT, WI-FI që ndihmon stafin mësimor dhe studentët, dhe lehtëson aksesin e tyre në dokumentacion elektronik, pajisjet dhe materialet didaktike. (evidenca X, Dokument nr. 70). Godina e fakultetit ka akses në internet, i cili ishte i aksesueshem nga personeli akademik dhe studentët e fakultetit. Dekani, përgjegjësit e departamenteve dhe stafi akademik kanë ambiente të dedikuara, për zhvillimin e aktivitetit jashtë orëve mësimore,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	të cilat edhe këto janë të pajisura me sistem kompjuterik.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në DVV, sipas evidencës, Dokumenti nr. 69 dhe nga vizita në institucion, e posaçërisht në sallën e bibliotekës apo takimi me studentët, GVJ konfirmon se biblioteka e UKZKM "Paolo Ruati" u ofron studentëve dhe pedagogëve një literaturë akademike adekuate për programin dhe në disa formate. Biblioteka përditëson dhe pasuron fondin dhe i siguron botimet e përditësuara, duke e bërë atë të disponueshme për studim dhe kërkim shkencor. Librat e bibliotekës janë në një larmi gjuhësh dhe formatesh (letër ose format elektronik). Shumica e librave janë në gjuhën italiane.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Duke u bazuar në evidencë, (RVB dhe vizita në institucion) sidomos nga takimi me studentët, GVJ konstaton se biblioteka e institucionit garanton numër adekuat të botimeve. Biblioteka përditësohet vazhdimisht me tituj mbi literaturën akademike më të fundit dhe alternative, në bazë të propozimeve që vijnë nga përdoruesit e saj. (evidenca 132, Dokumenti nr. 69). Po kështu mund të shfrytëzohet edhe portali i bibliotekës https://biblioweb.unizkm.edu.al/
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Gjatë vizitës dyditore në institucion u konstatua se personeli akademik si dhe studentët kanë mundësinë jo vetëm të shfrytëzojnë fondin e pasur të bibliotekës, por edhe librarinë online nëpërmjet portalit https://biblioweb.unizkm.edu.al/ Kjo hapësirë iu siguron atyre kërkimin në internet të një game akoma më të gjerë literaturës në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Procesi akademik dhe kërkimi shkencor sidomos mbështetet nga biblioteka duke vënë në dispozicion të përdoruesve bashkëpunimin e saj me bibliotekat e tjera përmes OPAC dhe CDD. Në këtë kuadër GVJ konfirmon përmushjen e këtij kriteri.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Studentët kanë në dispozicion të laboratorin e informatikës i pajisur me 48 Laptopë të vendosur në Godinën qendrore si dhe laboratorë të tjerë që mbështesin mësimdhënien përkatëse të shkencave kimike dhe biologjike e toksikologjike në program, p.sh.: Laboratori i Kimisë, i Përgatitjeve galenike apo Laboratori Biokimik-Klinik (evidenca 137, Dokumenti nr.74 - Raport

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	përshkrues mbi laboratorët).			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ konfirmon se UNIZKM ka një software të menaxhimit universitar të quajtur UniMS (University Management System). që dixhitalizon të gjithë informacionin e të dhënave të prodhuara gjatë proceseve të mësimdhënies dhe punës administrative. Një sistem menaxhimi i llojit ERP (Enterprise Resource Planning) i menaxhon dhe koordinon të gjitha proceset e universitetit. Sistemi është zhvilluar brenda universitetit sipas Statutit dhe procedurave dhe rregulloreve të tij.</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Të integruar me këtë ERP janë disa satelitë si portali i studentëve si pikë kryesore e informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe studentëve; portali i pranimeve që iu shërben studentëve të ardhshëm; portali i bibliotekës; WiFi dhe Kampusi; Real Time Classroom si modul i lidhur me TV Signage që janë në secilën ndërtesë dhe japin në kohë reale gjendjen e klasave, pedagogëve, programit të studimit, lëndës dhe klasës; Students' App (aplikacion celular që ofron të gjitha shërbimet e portalit studentor). Po ashtu IAL përdor Google Classroom, i cili është integruar me Google Meet dhe me Sistemin e Menaxhimit të Universitetit, për të bërë të mundur mësimin në internet. Gjithashtu IAL ka plaformë Provimi Online - plaformë e zhvilluar në shtëpi për <i>“online proctored assessment”</i> https://unizkm.al/categories/didattica-online/posts/.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se stafi akademik udhëzon studentët në zgjedhjen e temave të diplomave si dhe asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre (kjo ndiqet nga një pedagog udhëheqës që ndihmon në punën kërkimore dhe mbështet zhvillimin e temës si dhe një pedagog ndihmës). Si pjesë e kësaj mbështetje, studentëve u shpërndahet Rregullorja e Temës së Diplomës (evidenca 134, Dokumenti nr. 71) e cila tregon të gjitha hapat, që studentët duhet të përcjellin duke përfshirë edhe formularët përkatës (evidenca 135, Dokumenti nr. 72).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	UKZKM ka të ngritur Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (NjVBC) që përbën një mekanizëm shumë të vlefshëm për monitorimin, kontrollin dhe supervizimin e programeve të studimit në mënyrë të paanshme. Përgjegjësitë e detyrat e kësaj njësie janë të pasqyruara në Evidencën 167, Dokumenti nr. 110 . Një mekanizëm tjetër për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e mësimdhënies, që vërehet si në RVB, por edhe gjatë vizitës në institucion është roli i Koordinatorit të Programit të Studimit si dhe zyra të tjera të Universitetit. Këta aktorë sigurojnë të dhënat e nevojshme për NjVBC për të qenë në gjendje të monitorojë dhe vlerësojë aktivitetin e çdo programi studimi.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UKZKM dhe FF, fakulteti dhe departamentet janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në programin e studimit. Janë njësitë bazë, të cilat kontrollojnë dhe përgjigjen për cilësinë, sigurohen që personeli akademik dhe studentët të jenë të vetëdijshëm për cilësinë e programit të studimit. Duke qenë një program dygjuhësh, i cili ofrohet në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Farmacisë-Shkencave të Barnave të Universitetit të Barit në përputhje me Marrëveshjen e nënshkruar (evidenca 81, Dokument nr. 5) edhe aktiviteti mësimor duhet të përmbushë edhe standartet italiane të cilësisë së mësimdhënies, gjë që përbën një pikë të fortë të tij. Gjatë takimeve me stafin akademik ishte e qartë se njësia kryesore/bazë është e ndërgjegjshme për cilësinë e programit aktual dhe nevojës për përmirësimin e tij në të ardhmen, në përputhje me kërkesat e kohës.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të	Njësia kryesore dhe njësia bazë mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative didaktike edhe me përdorimin e sistemeve informatike. Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe rritja e sensibilizimit në lidhje me të në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

mësimdhënies.	nivele të personelit akademik apo të studentëve është përgjegjësi e departamenteve dhe njësive kryesore. Stafi akademik zbaton metodologji të reja mësimore në klasë dhe në laborator duke përfshirë këtu edhe adaptimin e mësimdhënies gjatë periudhës së pandemisë.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ konstaton se kualifikimi i vazhdueshëm i stafit të pedagogëve bazohet në veprimtarinë kërkimore të tyre ku pjesë të rëndësishme në këtë kualifikim të vazhdueshëm ka pjesëmarrja e pedagogëve në konferenca, kurse, organizim dhe menaxhim të projekteve dhe grupeve të kërkimit shkencor (Tabelat përmbledhëse, Tabelat nr. 19, 20, 22). Një tregues tjetër i rritjes së kualifikimit të pedagogëve janë edhe progresi në gradat shkencore e titujt akademikë, që ata mbajnë gjatë këtyre 6 viteve të fundit. (Tabelat përmbledhëse Tabela nr.7). Ky kualifikim i vazhdueshëm ndihmon përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies përse i përket mësimdhënies së orientuar nga kërkimet shkencore.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Sipas RVB, si pjesë e aktiviteteve të Departamenteve, pedagogët diskutojnë në mënyrë periodike metodat e përdorura të mësimdhënies dhe propozojnë procese përmirësimi dhe verifikimi për to. Çdo lëndë e këtij programi studimi i nënshtrohet kontrolleve të vazhdueshme nga titullarët dhe pedagogët mbështetës për të identifikuar çdo proces përmirësimi dhe aplikimin e metodologjive të reja. <i>Evidencë konkrete (pra shembuj konkret) përse i përket trajnimit të vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies nga njësitë përgjegjëse nuk është hasur në dokumentacion apo gjatë takimeve të GVJ në institucion.</i>
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në RVB dhe nga takimet në institucion GVJ vëren se ka një bashkëpunim të ngushtë midis personelit akademik italian, më me eksperiencë dhe atij shqiptar në moshë më të re, për përmirësimin e vazhdueshëm dhe futjen e metodave të reja të mësimdhënies. Ky fakt u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët. Po kështu edhe rezultatet e pyetësorëve të studentëve reflektojnë një angazhim maksimal të personelit akademik dhe ndihmës-akademik për zbatimin sa më rigoroz të programit të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	studimit, qoftë edhe në kushtet e pandemisë COVID-19.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ vëren se personeli akademik dhe ai ndihmës akademik kanë pasur rastin të testojnë metoda të reja në mësimdhënie, sidomos transformimi masiv i metodës së mësimdhënies gjatë pandemisë. <i>Përsa i përket analizës së efekteve dhe raportimit në mënyrë periodike të rezultateve, kjo nuk është shumë evidente, por, sic është cekur më lart, personeli vazhdimisht organizon takime me studentët, ku mund të marrin feedback për metodat e reja në mësimdhënie dhe studentët, po ashtu kanë mundësi të vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies përmes anketave.</i>			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit didaktik me Fakultetin e Farmacisë të UniBa, shkëmbimi i ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ndërmjet partnerëve është evident.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ vlerëson se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme. Programi ka një Rregullore Mësimore të Programit të Studimit (evidenca 93, Dokument nr 21), një Rregullore për Temën e Diplomës (evidenca 134, Dokument nr. 71) dhe Praktikën (evidenca 95, Dokument nr. 23), ku përcaktohen kërkesat dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të përfuara si edhe hartimi dhe mbrojtja e temës etj.
Kriteri 2. Në fillim të çdo	Bazuar në RVB dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion, Programi

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>i studimit MSc. Farmaci ka të përcaktuar qartë të gjitha veprimtaritë formuese dhe vlerësimit të njohurive. Koordinator i programit informon studentët për përmbajtjen e <i>syllabus</i>-ve të lëndëve dhe më pas studentët informohen specifikuat nga pedagogu i lëndës për metodologjinë e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale. Këto të dhëna janë të aksesueshme edhe online, konsultimit të syllabuseve të secilës lëndë ku deklarohen si elementët e mësimdhënies edhe mënyra e vlerësimit, përqindjet që zë secili element në vlerësim. <i>GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Duke u bazuar në evidencë, syllabuset e dorëzuara në DVV, (Evidenca 112, Dokument nr. 54) si dhe takimet në institucion, veçanërisht me studentë të viteve të ndryshme, kontrolli i njohurive të fituara nga studentit bëhet në forma dhe mënyra të ndryshme gjatë programit të cilat përshtaten me natyrën e objektivave të mësimdhënies. Vlerësimi kryhet përmes një provimi përfundimtar, i cili mund të marrë parasysh elementë të ndryshëm si për shembull, ushtrimet në klasë ose laborator, ose veprimtari të tjera me shkrim dhe/ose praktike të kryera nga studentit paraprakisht. Studentit duhet të kalojë testet me shkrim dhe/ose praktike, të cilat janë pjesë përbërëse e provimit dhe mos kalimi i këtyre mund të rezultojë në mos pranimin e studentit në provimin përfundimtar me gojë nga komisioni. Procedura e vlerësimit është transparente dhe studentët janë të informuar mbi detyrimet që kanë në përfundim të lëndës modulit. Një punë plotësuese informimi bën koordinatori i programit të studimit. <i>GVJ konstaton se studentit ka mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në disa forma. GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.6
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit..

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të dijeve dhe testimi i tyre bëhej në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë semestrit apo vitit akademik, në varësi të periudhës së zhvillimit të lëndë/moduleve. Neni i tetë i Rregullores Mësimore (evidenca 93, Dokumenti nr. 21) përcakton se kontrolli i njohurive të fituara nga studenti kryhet përmes një provimi përfundimtar, i cili mund të marrë parasysh elementët që realizohen gjatë gjithë vitit akademik, p.sh.: ushtrimeve në klasë dhe laboratorike ose veprimtari të tjera të shkruara dhe /ose praktike të kryera nga studenti. Studenti duhet të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara në programin mësimor dhe rregulloret që të fitojë të drejtën për të dhënë provimin e një lënde të caktuar. Mënyrat e zhvillimit të provimit janë të detajuara në Syllabus-in përkatës. (Evidenca 112, Dokumenti nr. 54).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në DVB, GVJ vëren se institucioni ka dokumentuar procesin gjatë pandemisë COVID-19 ku provimet u kryen në mënyrë elektronike duke u përdorur Shërbimi Terminal Student. Raporti i vetëvlerësimit komunikon në detaje procesin e provimeve online që janë përdorur gjatë pandemisë dhe GVJ konstaton se këto procese kanë sigurinë e nevojshme të eliminojnë forma të ndryshme abuzimi (evidenca 133, Dokumenti nr. 70; https://unizkm.al/categories/didattica-online/posts/)</p> <p>Pedagogu i lëndës së bashku me Koordinatorin mësimor përcaktojnë datën, mënyrat e zhvillimit të provimit (evidenca 138, Dokumenti nr. 75), materialet që do të përgatiten dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Këto informata iu komunikohen studentëve para përfundimit të veprimtarisë mësimore. <i>Edhe pse nuk është e qartë se sa përdoren sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit në program në kushte normale, GVJ konstaton se Institucioni ka krijuar të gjitha kushtet për një gjë të tillë, pra ky kriter përmbushet.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së</p>	<p>GVJ vëren se për testimet përfundimtare të studentëve, bazuar në Rregulloren mësimore (Evidenca 107, dokumenti nr.21) ngrihen Komisionet e secilit provim nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me titullarët e lëndëve dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>miratohen nga Dekani i Fakultetit. Provimet realizohen me sekretim kur ato zhvillohen me shkrim. Para se të futen në provim, studentët identifikohen nga komisioni i provimit, i cili përbëhet nga të paktën dy pedagogë që kanë dhënë lëndën (për provimet për një lëndë të vetme) apo dy ose më shumë pedagogë kur provimi është i integruar. <i>GVJ vlerëson se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe përshkrimin e dhënë gjatë takimeve në Institucion, për testimin me shkrim, ditën e provimit, pedagogu i lëndës i dërgon testin përkatës, Koordinatorit, i cili sigurohet që testi të ketë vulën e Sekretarisë Mësimore. Prandaj, provimet me shkrim protokollohen. Për t'u identifikuar, studenti paraqitet në provim me librezën e tij universitare me një foto ose në rast se nuk e ka, me një dokument identifikimi siç është letërnjoftimi ose pasaporta e tij. Kopjet e tezave të testeve me shkrim u shpërndahen studentëve dhe testi sekretohet. Kjo procedurë zhvillohet nga Sekretaria Mësimore, e cila bashkëngjit një zarf me një fletë brenda tij. Fleta plotësohet nga studenti me të dhënat e tij/saj dhe mbyllet dhe vulozet nga vetë studenti. Korigjimi i provimit bëhet me zarf të mbyllur, hapja e tij bëhet në prani të Komisionit dhe studentëve. Kjo procedurë parashikohet edhe në rregulloren përkatëse.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL e konsideron të rëndësishëm suportin e studentëve në akumulimin e njohurive, dijeve dhe aftësive, si dhe përmirësimin e tyre në këtë rrugëtim. Provimet/ ushtrimet /testet me gojë shoqërohen me komente për të ndihmuar studentin të përmirësojë punën e tij në të ardhmen. Gjithashtu nëse studenti është i paqartë për vlerësimin ai/ajo mund të kontaktojë Koordinatorin e Programit ose direkt pedagogun për të caktuar një takim sqarues. Ky fakt i përshkruar në RVB, u konfirmua edhe nga deklaratimet e studentëve gjatë takimit në Institucion.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstaton se Personeli akademik i FF/UKZKM dhe i gjithë personeli drejtues i fakultetit kanë "0" tolerancë ndaj kopjimit, apo plagjiaturës. Për testimin me shkrim Institucioni merr të gjitha masat që kjo të mos ndodhë dhe ua bën të ditur studentëve që përpara fillimit të provimit (evidenca 138, dokumenti nr.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	75; evidence 137, Dokumenti nr.70). Përsa i përket Punimit të diplomës plagjatura është e dënueshme dhe kjo iu bëhet e ditur studentëve me gojë, por njëkohësisht përcaktohet edhe në Rregulloren e punimit të diplomës, që iu jepet studentëve para filimit të punës.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale, të cilat bazohen në meritë, jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse (evidenca 138, Dokument nr. 75). Shpallja e rezultateve të provimeve bëhet brenda afateve të përcaktuara në <i>Rregulloren e programit të studimit</i> dhe janë reflektime të drejta në lidhje më vlerësimin real të dijeve dhe njohurive të studentit.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas rregullores së provimit që shërbeu si evidencë pranë GVJ, studenti ka të drejtë të ankohet kundër vlerësimit (evidenca 138, Dokumenti nr. 75), nëse pretendon se rregullat për mënyrën e zhvillimit të provimit janë shkelur ndaj tij apo nuk pajtohet me vlerësimin e marrë. Studentëve iu vihet në dispozicion një formular tip për të shprehur mospajtimin e tyre me rezultatin e marrë. (Evidenca 142, dokumenti nr.77)			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Studenti ka të drejtë të sqarojë çdo paqartësi që rezulton, ose të kundërshtojë rezultatin në prani të Komisionit kur rezultati komunikohet. Komisionit të Provimit i kërkohet t'i shpjegojë studentit vlerësimin e kryer dhe nëse provimi është gjithashtu në formë të shkruar, duke krahasuar përgjigjet e studentit me tezën e zgjedhur. Nëse ai më vonë nuk pajtohet me argumentin dhe vlerësimin e komisionit, studenti mund të bëjë ankesë me shkrim (evidenca 142, dokumenti 77) drejtuar Dekanit përmes formularit brenda 3 ditëve nga publikimi i rezultatit. Ankimimi trajtohet nga Dekani. Nëse ka gabim që është bërë nga Komisioni në procesverbalin e provimit (evidenca 140, Dokumenti nr. 76) duhet të pasqyrohet në një procesverbal.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

X

Standardi III.7


Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit “Master i Shkencave” në Farmaci garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Kjo kurrikul është organizuar në 5 vite akademike ka 30 lëndë/module ku peshën më të madhe e zënë Lëndët karakterizuese 60%, nëpërmjet të cilave studenti brumoset dhe thellon njohuritë në disa drejtime kryesore të farmacisë (referuar Programi i studimit dhe Tabelat Përmbledhëse Tabela nr. 9) si përgatitja e formave farmaceutike konvencionale, proceseve farmakokinetike që janë baza e farmakologjisë së përgjithshme etj.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ konstaton se Programi i studimit ka përputhje me disa nga praktikat më të mira europiane dhe është bazuar në nevojat që ka ky profesion si dhe në trendet e zhvillimit të farmacië dhe teknologjisë që aplikohet në të. Mund të thuhet se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, mbështetur edhe nga infrastruktura moderne; aftësi sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit, nëpërmjet lëndëve të tilla si Informatikë e statistikë mjekësore, Praktikë në farmaci apo Njohuri e gjuhës së huaj (përpos që zhvillimi i mësimi bëhet në gjuhën italiane).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin përmbajtjen e saj dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat përkatëse mbi aftësitë dhe kompetencat që pritet të fitojë student paraqiten jo vetëm në përmbajtje të programit të studimit, por në çdo syllabus të veçantë.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë	Bazuar në RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	vëren se studentët njihen që në fillim të lëndës/modulit në lidhje me mënyrën e vlerësimit përfundimtar. Në javën e fundit të lëndës studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton se Personeli akademik me kohë të plotë integron të reja më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Fakulteti i Farmacisë dhe UKZKM vazhdimisht organizojnë leksione dhe semiare të hapura për përmbushjen e plotë të këtij standardi, evidentuar me disa shembuj të seminareve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë (Referuar DVB Dokumenti 32, 33, 34 dhe 36, 37, 38).
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Ndërsa sa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimi të kompetencave të studentëve, departamentet dhe të gjitha strukturat e Fakultetit të Farmacisë bashkërendojnë punën, ofrojnë ndaj studentëve të gjithë infrastrukturën e nevojshme për t'i dhënë studentëve mundësi të zhvillojnë praktikat dhe laboratorët profesionale. Bazuar në gjetjet gjatë vizitës në institucion punët laboratorike zhvillohen individuale duke bërë të mundur që secili student të zhvillojë aftësitë e veta praktike në secilën prej lëndëve të profesionit. Shpesh herë në disa laboratorë ata testohen për njohuritë me teste laboratorike.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Bazuar në RVB GVJ konstaton se objektivi final i personelit akademik është të nxënit e njohurive, autonomia e gjykimit dhe aftësimi për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme profesionale. Megjithatë ky synim nuk mbështetet me ndonjë shembull konkret.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	IAL duhet të punojë më shumë në këtë drejtin pasi GVJ nuk gjeti asnjë evidencë se personeli akademik apo institucioni krijon klimë të përshtatshme apo nxit zhvillimin e ideve inovative dhe studime të avancuara kërkimore e shkencore (si p.sh. publikime apo prezantime të përbashkëta mes stafit akademik dhe studentëve).
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e	Bazuar në RVB, si dhe në gjetjet gjatë vizitës në Institucion u

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	soll si shembull i mbështetjes financiare vetëm 1 (një) rast i ofrimit të bursës për një studente të ciklit të tretë në Universitetin e Milanos. GVJ vlerëson se nxitja e studentëve për zhvillimin e ideve inovative apo studimeve të avancuara kërkimore e shkencore duhet të jetë më e gjerë.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Bashkëpunimi didaktik për programin e studimit në Farmaci me Fakultetin e Farmacisë të Universitetit të Barit garanton shkëmbim të ndërsjellë në fushën e kërkimit shkencor në sektorin farmaceutik dhe lëvizshmërinë e studentëve ndërmjet tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni ka të përcaktuar qartë procedurën për diplomimin e studentëve të tij në përfundim të studimeve (evidenca 134 Dokumenti nr. 71 - Rregullorja e Temës së Diplomës). Studenti me përfundimin e studimeve pajiset me diplomë të përbashkët të UKZKM dhe Uni BA, pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik (duke përfshirë Koordinatorin e programit) udhëzojnë dhe ndihmojnë studentët duke siguruar informacion dhe materiale të nevojshme për temën e diplomës. Performanca dhe progresi i studentëve gjatë periudhës së punimit të temës së diplomës ndiqet dhe monitorohet përmes takimeve të rregullta me udhëheqësit. Këto takime fillimisht fokusohen në përcaktimin e temës dhe strukturës së punimit, dhe më vonë në hartimin dhe zbatimin e metodës së përcaktuar të studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	Takimet përfundimtare i kushtohen tërësisht vlerësimit të analizës së kryer dhe interpretimit të rezultateve.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas RVB –se, programi i studimit përfundohet me dhënien e një provimi përfundimtar në formë diskutimi të një punimi me shkrim që mund të ketë të bëjë me: mbledhjen dhe përpunimin kritik të materialit bibliografik ose të dhënave të tjera përkatëse dhe përmbajtjeve të programit të studimit (temë bibliografike); Paraqitje dhe diskutim i të dhënave të mbledhura gjatë veprimtarisë eksperimentale gjashtë mujore të realizuar në një temë origjinale. Kriteret e vlerësimit të provimit përfundimtar marrin parasysh mesataren e provimeve të dhëna gjatë gjithë programit, punimin e temës, periudhën e kaluar për marrjen e diplomës si dhe çdo periudhë qëndrimi jashtë vendit. (evidenca 134, Dokumenti nr. 71).
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Në programin e studimit Master i Shkencave në Farmaci, është detyrim ligjor (Ligji Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015), përmbyllja e ciklit të studimeve me punim diplome. Punimi i diplomës është një punim i pavarur shkencor i studentit. Në bazë të RVB dhe diskutimeve në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se përcaktimi i temës së diplomës bëhet përmes një bashkëpunimi midis studentëve dhe personelit akademik. Studenti bazuar në prirjet dhe synimet e tij diskuton me pedagogun e subjektit përkatës dhe më pas vendoset ose nëse vetë pedagogët kanë një projekt studimi mund ta hedhin për diskutim dhe zgjidhet studentin më i përshtatshëm, gjithnjë në mirëkuptim të të dyja palëve.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në RVB si dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se studentët asistohen gjatë punimit të mikrotezës nga 2 udhëheqës, njëri primar dhe tjetri asistent (zakonisht një pedagog italian dhe një shqiptar). Udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afate të përafërta të realizimit të tij. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Nëse ato janë në përputhje rezultatet e pritshme, udhëheqësi jep udhëzimet e nevojshme dhe orienton studentin për zhvillimin e mëtejshëm të diplomës. Udhëheqësi

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>garanton shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Vetëm me miratimin e tij, studenti mund të dalë për mbrojtje para komisionit të diplomimit. (evidenca 134, Dokumenti nr. 71, Dokumenti nr. 79). Gjatë takimit me përfaqësues të institucionit u vu re se shumica e studentëve favorizojnë temën bibliografike (e jo atë eksperimentale). Shkaku për këtë zgjedhje ishin kohëzgjatja më e madhe e punimit të temës eksperimentale në krahasim me atë kompilative dhe si pasojë diplomimi me vonesë; gjithashtu edhe fakti që temat eksperimentale në laborator zhvillohen kryesisht në UniBa.</p> <p><i>GVJ e konsideron këtë fenomen si mundësi të pashfrytëzuar, sepse dy palët – si studentët dhe institucioni - do të përfitonin nga temat eksperimentale (p.sh.: institucioni do të përmbushte disa standarde të tjera të sipërpërmendura që kërkojnë këtë).</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë</p>	<p>Komisioni i diplomimit emërohet nga Rektori dhe përbëhet nga Dekani i Fakultetit të Farmacisë të UKZKM, ose zëvendësi i tij, dhe jo më pak se shtatë pedagogë, nga të cilët të paktën tre janë titullarë të lëndëve zyrtare të Fakultetit. Mënyra e vlerësimit të temës përcaktohet qartë në Rregulloren e diplomimit (evidenca 134, Dokumenti nr. 71). Faza përfundimtare përfshin përgatitjen e Procesverbalit të Provimit të Diplomimit nga Sekretaria Mësimore dhe plotësimin e tij me notën përfundimtare nga Komisioni (evidenca 143, Dokumenti nr. 78). Nota e diplomimit, e shprehur në njëqind e dhjetë përcaktohen nga mesatarja aritmetike (e ponderuar në ECTS) e notave të marra në provimet kurrikulare të shprehura në njëqind e dhjetë dhe pikët e mbrojtjes së temës (të dhëna nga Komisioni i Diplomës), ku tema bibliografike ka maksimum 5 pikë dhe ajo eksperimentale ka maksimum 10 pikë (evidenca 134, Dokument nr. 71).</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma miratohet paraprakisht nga Senati i Universitetit, dhe në vazhdim nga MASR (Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë). Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. (evidenca 145, Dokumenti nr. 80).			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen	Dokumentacioni lidhur me studentët ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin në të dy vendet Shqipëri dhe Itali.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari	Bazuar në RVB dhe takimet e zhvilluara në institucion u konstatua se UKZKM ka një bazë të dhënash të hollësishme dhe të mirëorganizuara për personelin akademik të brendshëm, të jashtëm e të ftuar etj. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë Zyrës së Personelit të IAL dhe është e përditësuar (evidenca 147, dokumenti nr. 82). Gjithashtu këto të dhëna i ka edhe Zyra e statistikave për qëllimet e veta. Gjatë takimeve në institucion GVJ kërkoi nga zyra e Burimeve Njerëzore të IAL të njiheshin me tri dosje, personel akademik të brendshëm (PAE) vendas dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>italian si dhe personel akademik të jashtëm (PAK) shqiptar të Fakultetit të Farmacisë (UKZKM). GVJ konstatoi se dosjet ishin të plota dhe përmbanin të gjithë dokumentacionin/informacionin e nevojshëm përfshirë CV, kërkesat për aplikim për vendin vakant, fotokopje të noterizuara të diplomave, të gradave, titujve akademikë si dhe listë notash si për personelin shqiptar, edhe për atë italian, po ashtu edhe për PAK etj.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në bazë të evidencave të paraqitura në DVV, si dhe informacionit të publikuar në faqen zyrtare të UKZKM, referuar njoftimeve të vendeve vakante (evidenca 148 Dokumenti 84) IAL ka hartuar dhe zbatuar procedurat për rekrutimin e personelit akademik (staf i brendshëm dhe i jashtëm). Procedurat bazohen në statutin, rregulloren e institucionit (evidenca 89, Dokumenti nr. 15 dhe evidenca 149, Dokumenti 85), në Kodin e Punës dhe statusin e personelit akademik.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Sipas gjetjeve në RVB, si dhe takimeve në institucion GVJ vëren se procedurat për rekrutimin e personelit janë përcaktuar në dokumentacionet bazë, Rregullore për procedurat dhe menaxhimin e burimeve njerëzore (evidenca 149, Dokumenti 85), Kodi i punës në RSh si dhe Ligjin 80//2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kriteret e posaçme dhe specifike për të gjitha vendet e lira përcaktohen në departament dhe shpallen në faqen zyrtare të UKZKM pas miratimit nga Rektori.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Gjatë takimit në institucion me Përfaqësuesen e Zyrës së personelit mund të thuhet se Zyra e Personelit të IAL ndjek nga afër gjithë hapat e zhvillimit të procesit të rekrutimit nga shpallja e vendit të lirë në faqen zyrtare të institucionit, ngritja e komisionit ad-hoc dhe konkursi deri tek shpallja e fituesit dhe firmosja e kontratës. Gjetje të tilla u konstatuan edhe në RVB në lidhje me shpalljen e vendit të lirë personel ndihmës apo personel akademik mbështetur në evidenca. (evidenca 237, Dokumenti nr. 83; evidenca 238, Dokumenti nr. 84).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ vlerëson se personeli i Fakultetit të Farmacisë në UniKZKM ka hapësira dhe mjedise të dedikuara për personelin akademik dhe sekretarinë mësimore. Edhe gjatë vizitës në institucion u evidentua se personeli akademik e ushtron aktivitetin e tij tek godina qendrore, e cilat ka në sipërfaqe akomodimi 883.5 m ² (evidenca 151, dokumenti 87). Të gjitha ambientet rezultuan të pajisura me tavolina pune, kompjutera personalë me lidhje interneti, printera etj.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	UKZKM rezulton se angazhohet në vazhdimësi për t'i krijuar kushtet e nevojshme për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik. Metodatat e mbështetjes konsistojnë në ofrimin e mundësisë për të marrë bursa për studime doktore pranë institucioneve partnere, kryesisht në ato italiane, për të marrë pjesë në grupet kërkimore së bashku me kolegët italianë, për të prezantuar punimet shkencore në aktivitete të ndryshme shkencore brenda e jashtë vendit etj. Në këtë kuadër Fakulteti i Farmacisë ka hartuar një Formular aplikimi dhe autorizimi për të marrë pjesë në këto aktivitete (evidenca 150 Dokumenti nr.86) Gjithashtu në bazë vjetore përcaktohen fondi dhe rregullat mbi shpërndarjen e kontributeve në projektet e ndryshme kërkimore shkencore, rolin e komisionit, rolin e departamentit, projektet me rëndësi të veçantë për institucionin, të parashikuara këto edhe në buxhetin e Universitetit.(Evidenca 211, Dokumenti 62)
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodatat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja,	Fakulteti i Farmacisë, UniKZKM në bashkëpunim fillimisht me Universitetin Milanos (29.02.2012) (Evidenca 80, Dokumenti nr.4) dhe më pas me Departamentin e Farmacisë së UNIBA, Itali (7.7.2014) (Evidenca 81 Dokumenti nr.5) jo vetëm në kuadër

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.	të pandemisë, por edhe më parë ka përdorur dhe përdor metoda inovative të mësimdhënies të zbatuara nga UNIBA qysh në vitin 2017. Ky program është përzgjedhur si një nga programet më inovative në nivel rajoni dhe për këtë ka marrë një fond të konsiderueshëm financimi nga Krahina e Puglia-s.								
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve	Sipas gjetjeve të GVJ, Fakulteti i Farmacisë për të përbushur të gjitha nevojat e mësimdhënies rezulton të ketë angazhuar staf me kohë të plotë të kombinuar midis atij të Universitetit të Barit, Itali dhe atij shqiptar. Së fundi janë punësuar 3 staf akademik vendas me kohë të plotë me synimin për të përbushur nevojat me staf akademik shqiptar. Gjithësesi ky fakultet është i mirëorganizuar dhe ka kapacitet të mjaftueshëm të burimeve njerëzore, (26 PAE, nga të cilët 12 UKZKM dhe 14 UniBa si dhe 11 PAK) për të mbuluar dhe realizuar të gjithë ngarkesën mësimore dhe kërkimore të programit Master i Shkencave në "Farmaci". (Evidenca 169, Tabelat përmbledhëse, përkatësisht Tabelat nr.1 dhe nr.2).								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ vlerëson se Fakulteti i Farmacisë UniKZKM ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme, e cila siguron zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor (evidenca 151, dokumenti 87). Përveç godinës qendrore, në një godinë më vehte në krah të saj janë të vendosur dy laboratorët didaktikë, ai kimiko-farmaceutik dhe ai farmaceutik në shërbim të mësimdhënies. Gjithashtu sipas gjetjeve të GVJ, Bazuar në RVB, UniZKM disponon edhe një sërë laboratorësh të tjerë si ai mikrobiologjik, ai i studimit të pavarur dhe anatomik, ambientet e studimit, biblioteka, nyje


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>higjeno-sanitare etj, që përdoren edhe në kuadër të Programit të studimit Master i Shkencave “Farmaci” (referuar Evidencës 262 në gjuhën angleze, dokumenti 32). Bazuar edhe në të dhënat mbi numrin e studentëve GVJ shprehet se FF, UniKZKM zotëron një sipërfaqe të konsiderueshme duke respektuar standartet e kërkuara në lidhje me raportin sipërfaqe m²/student.</p> <p>Fondacioni “NSBC” zotëron 4688.2 m2 nga të cilat 883.50 m2 janë ndërtim me 4 kate. Në dispozicion të Programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” janë 5 salla mësimi, leksion e seminare dhe 2 laboratorë të pajisur mirë që në total llogariten 13.7 m²/student e plotësojnë kriterin (5 m²/student) që kërkon standardi¹. GVJ konkludon se raporti sipërfaqe m²/student është brenda normave të standardit.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore të FF janë të pajisura me salla leksionesh, seminaresh dhe ambiente për laboratorët. Ambientet janë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor si në auditor edhe online. GVJ konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion se këto mjedise kanë numër postesh të përcaktuar sipas numrit të studentëve të planifikuar p.sh.: laboratorët kanë një kapacitet për të akomoduar 18 studentë, të cilët do të mund të punonin secili në mënyrë individuale (referuar vizitës në institucion).</p> <p>Mjetet audio-vizuale janë të instaluar në të gjitha mjediset mësimore, të pajisura me videoprojektorë, laptopë dhe e gjithë ndërtesa qendrore është e pajisur me akses në internet, ka laborator informatike të pajisur me 48 laptopë. Është 10, Gjithashtu salla e bibliotekës është e pajisur me kompjutera ka edhe 3 PC AIO në dispozicion të studentëve e pedagogëve për qëllime kërkimore shkencore.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e</p>	<p>Fakulteti përveç laboratorëve të vënë në dispozicion për zhvillimin e orëve laboratorike (evidenca 151, Dokumenti nr.87), përdor edhe mjediset e UniKZKM si dhe ato të poliklinikës At Luigi Monti. Gjatë vizitës në institucion u vu re se laboratorët didaktikë ishin të pajisur me të gjitha aparaturat e nevojshme për realizimin e seancave praktike të parashikuara në</p>

¹Referuar takimeve gjatë vizitës në institucion raporti është llogaritur nga sa pamë pasi RVB nuk kishte të dhëna specifike në lidhje me këtë argument..

<p>praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>programin mësimor.</p> <p><i>Gjithësi GVJ sygjeron që të shtohet sasia e orëve laboratorike për këtë program studimi dhe si pasojë edhe llojet e pajisjeve. Kjo do të ndihmonte në pajisjen e studentëve me njohuri praktike jo vetëm mbi metodikat bazë, por edhe mbi ato më të avancuara dhe pajisjet përkatëse të kontrollit farmaceutik që në ditët e sotme përdoren rutinë në këtë sektor.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vlerëson se ambientet e FF janë të pajisura me kompjutera, në të cilët janë të instaluar sistemet operative Ëindoës si dhe paketat Microsoft Office shumë të nevojshme për studentët gjatë përpunimit të të dhënave laboratorike (ndërtimi i grafikëve, llogaritje të ndryshme të parametrave kimiko-fizikë).</p> <p>Studentët e programit të studimit të integruar Master i Shkencave në “Farmaci” mund të përdorin laboratorin e Informatikës të ofruar nga UniKZKM për të gjithë studentët e saj. Në të mund të punojnë njëkohësisht 48 studentë secili në vendqëndrimin e tij të pajisur laptop dhe me akses në internet ku janë instaluar programet e duhura profesionale.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>GVJ konstatoi se UniZKM për programin Master i Shkencave në “Farmaci” ka marrëveshje bashkëpunimi në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve si me UFSH (Evidenca 96, Dokumenti nr.24) dhe specifikisht për periudhën e pandemisë së Covid-19 (Evidenca 100, Dokumenti nr. 78) dhe me Urdhrin e farmacistit të Milanos e Lodit (Evidenca 98, Dokumenti nr. 26) fillimisht e sot me atë të krahinës së Puglias (Evidenca 97, Dokumenti nr. 25) siç parashikohen në programin mësimor 3 muaj në shtetin Italian dhe 1 muaj në Shqipëri dhe 2 muaj me zgjedhjen e vetë studentit në Itali ose Shqipëri. Po kështu pjesë e marrëveshjes me UniBa është edhe zhvillimi i punëve ekperimentale nga studentët në kuadrin e punimit të diplomës.</p> <p>GVJ duke marrë parasysh numrin e studentëve të FF, programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci” (sasia e orëve të laboratorit) vëren se 2 laboratorët profesionalë dedikuar posaçërisht praktikave të analizës kimike e toksikologjike apo përgatitje galenike si dhe ai i informatikës janë të mjaftueshëm</p>

	dhe të përshtatshëm për zhvillimin si duhet të tyre. (evidencat 151, Dokumenti nr.87 dhe Evidenca 137, Dokumenti nr. 74).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ shpreh mendimin se UniKZKM/F.F, disponon bibliotekë mësimore me hapësira dhe kapacitete të mjaftueshme dhe është e hapur në orare të përshtatshme dhe paralel me oraret e mësimi. Konkretisht UniKZKM zotëron bibliotekën, e cila gjendet në godinën qendrore bazuar edhe në vizitën e kryer në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e bibliotekës është dhe literatura bazë dhe e këshilluar e programit të studimit. Ky fakt u konfirmua edhe gjatë takimit të zhvilluar me Studentët. Referuar RVB, biblioteka e UniKZKM zotëron 17.000 tituj (libra dhe revista të printuara), nga të cilët 251 janë tekste specialiteti (Evidenca 132, Dokumenti nr.69).</p> <p>Tekstet mësimore janë në shqip dhe në gjuhë të huaj, italisht, anglisht. Njëkohësisht studentët dhe pedagogët mund të përdorin edhe portalin biblioëeb.unizkm.edu.al se edhe në rrjetet sociale Facebook Biblioteka Unizkm për t'u përditësuar me njohuritë më të reja shkencore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të</p>	<p>Si fondi i bibliotekës, po ashtu edhe akses online tek portali i përmendur më sipër janë pa pagesë për studentët, stafin si dhe bshkëpunëtorët.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

fushës së programit të studimit.									
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bazuar në RVB dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UniKZKM disponon në bibliotekën e tij një numër të konsiderueshëm kompjuterash si edhe projektorë. Këto pajisje mund të shfrytëzohen pa kufizim nga ana e studentëve. (Evidenca 152, Dokumenti nr.88).								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se UniKZKM ka një traditë të përvitshme të pasurimit të bibliotekës me tituj të rinj. Këta tituj propozohen nga vetë pedagogët çdo fillim viti akademik siç u përmend edhe pak më lart. Mund të thuhet se kjo praktikë e pasurimit me libra të rinj të fondit të bibliotekës është një tregues i përpjekjeve për të rritur cilësinë e procesit mësimor, jetës studentore, si dhe kërkimit shkencor.								
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Referuar RVB si dhe vizitës në vend, biblioteka ishte e vendosur në të njëjtën godinë me sistem akustik për moslejimin e zhurmave nga jashtë, me kushte ajrimi e ndriçimi shumë të mira. Të gjitha këto e bënin lehtësisht të aksesueshme nga studentët. Shërbimet në bibliotekë ofrohen nga ora 08:00-20:00 gjatë ditëve të javës dhe 09:00-14:00 të shtunën. Ndërkohë salla e leximit është 08.00-21.00 nga e hëna deri të dielën. (dokumenti nr.88 Rregullore e bibliotekës Neni 3). Gjatë takimit me studentët ata konfirmuan se salla e leximit është gjatë gjithë kohës e hapur përveç ditëve të disa festave fetare, është e pasur dhe me hapësira të mjaftueshme për ta.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të	Në bazë të gjetjeve tona, UKZKM/FF ka vënë në funksionim të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>plotë sekretarinë mësimore, e cila zotëron në formë të shkruar, regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin me të dhënat akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave (evidencat 153, 154, 155, përkatësisht dokumenti 89, 89.1, 89.2). E gjithë procedura është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe nenet përkatëse të sanksionuara në Statutin e IAL.</p> <p>Sekretaria mësimore arkivon gjithashtu, aplikimet e kandidatëve për studentë me dokumentacionin e dorëzuar prej tyre, dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e notave, dosjet e diplomimit. Në funksion të menaxhimit të informacionit UKZKM disponon edhe sistemin elektronik të komunikimit të brendshëm UNIMS, që ka rezultuar shumë i vlefshëm sidomos gjatë këtij viti akademik kur studentët nuk mund të paraqiteshin fizikisht në Universitet.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion Zyra e Burimeve Njerëzore vuri në dispozicion të GVJ tre dosje, personel akademik të brendshëm, një shqiptar dhe një i huaj si dhe personel akademik me kontratë. Dosjet personale të personelit akademik ishin të plota dhe përmbanin CV, kontratat e punës, diplomat e noterizuara etj dhe vlen të theksohet që ishin identike midis PAE shqiptar dhe të huaj si dhe PAK. Me këto te fudit ndryshonte vetëm kontrata që në rastin e PAE ishte e përhershme, ndërsa kontrata për PAK ishte e përkohshme.</p> <p>Referuar RVB (Evidenca 149, Dokumenti nr. 85), kjo zyrë administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik si dhe personelit administrativ. (Evidenca 147, 148, Dokumenti nr. 83, 84)</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se UKZKM/FF ka infrastrukturën e nevojshme, e cila siguron një sistem menaxhimi të dedikuar dhe konfidencial për personelin akademik, ndihmës-akademik, personelin administrativ dhe studentët. Informacionet personale administrohen në përputhje me Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit realizohet nëpërmjet zyrës së Burimeve Njerëzore.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik komunikon në mënyrë të rregullt me studentët nëpërmjet platformës e-learning e integruar në sistemin e menaxhimit të informacionit UniMS. Nëpërmjet kësaj</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	platforme personeli akademik ju ofron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me aktivitetin mësimor. Studentët e aksesojnë informacionin nëpërmjet llogarive të tyre. Në të njëjtën mënyrë sigurohen edhe informacionet nga sekretaria mësimore dhe administrata.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Bazuar në të dhënat e RVB dhe faqes zyrtare të UniKZKM, është aktiv edhe STUDENTAPP, e cila mundëson raportimin e të gjithë aktivitetit akademik semestral dhe vjetor të Fakultetit të Farmacisë, bibliotekës etj. Nëpërmjet këtij aplikacioni studentët mund të aksesojnë të gjitha informacionet e nevojshme direkt nga telefonët e tyre celular.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Referuar faqes zyrtare të internetit të UKZKM (https://unizkm.al), Fakulteti i Farmacisë ka vënë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në "FARMACI". Informacioni dhe aktivitetet lidhur me programin përditësohen rregullisht. Informacionet në faqen zyrtare janë jo vetëm në shqip dhe italisht, por edhe në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas gjetjeve në RVB, tarifat e shkollimit miratohen çdo vit nga IAL për çdo cikël studimi (evidenca 163, Dokumenti nr. 102). Në kuadër të raportit vjetor, IAL harton periodikisht edhe raportin financiar për mbarëvajtjen e programit për ciklin e plotë të studimit. Ky raport vjen edhe në kuadër të Bilancit në total të Fondacionit ZKM. Në të përfshihen jo vetëm veprimtaritë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	arsimore por edhe veprimtaritë e tjera të tij.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Referuar RVB, Fakulteti i Farmacisë harton çdo vit plan-buxhetin, i cili përfshin pagesat e personelit akademik (PAE), personelin akademik të jashtëm ose të ftuar, personelin ndihmës-akademik, personelin administrativ, bursat e meritës për studentët, investimet për laboratorët mesimorë dhe kërkimorë, shpenzime për pasurimin e fondit të bibliotekës, kërkesat për pajisjen me kompjutera dhe videoprojektorë. Në mbështetje të rritjes profesionale të personelit akademik FF planifikon në plan-buxhet mbështetje financiare për konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, për të cilat ka edhe një rregullore më vehte. (Evidenca 121, Dokumenti nr. 62)
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifrat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Bazuar në RVB GVJ konstaton se raportet financiare vjetore të UKZKM i nënshtrohen auditimeve të brendshme e të jashtme në mënyrë periodike. UKZKM kryen në mënyrë të përvitshme auditin e brendshëm, i cili realizohet nëpërmjet Sektorit të Auditit të Brendshëm (referuar organigramës së UKZKM). Raportet financiare përmbajnë informacione të detajuara lidhur me të ardhurat dhe tarifrat e shkollimit.
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	GVJ vëren se UKZKM si dhe FF hartojnë në mënyrë periodike plan-buxhete, të cilët përmbajnë analiza financiare të hollësishme duke përfshirë të gjithë zërat e nevojshëm për realizimin e programit të studimit. Përveç plan-buxheteve UKZKM/FF realizon edhe analizat financiare vjetore dhe identifikon/planifikon ndërhyrjet e nevojshme për ecurinë normale të programit.
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete	GVJ konstaton se Universiteti Zonja e Këshillit të Mirë si IAL jopublike siguron mbështetjen financiare jo vetëm nëpërmjet tarifave të studentëve, por edhe nëpërmjet aktiviteteve ekonomike të Fondacionit ZKM, Klinika e specialiteteve AT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Luigji Monti etj. Në bazë të tabelës në faqen 59 të RVB, mund të thuhet se pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë ato operative me 23%, pagesat për pedagogët 13% investimet 10% transfertat ndërkombëtare 7% , kërkimi shkencor 3% dhe për bursa studimi 0.7%.</p> <p>Në dritën e sa më sipër, GVJ mendon se IAL ka qëndrueshmeri financiare.</p> <p><i>FF në veçanti ka një numër të vogël studentësh, i cili kufizon kapacitetet financiare të këtij fakulteti <u>GVJ sugjeron se FF duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të rritur numrin e studentëve në programin e studimit dhe duhet të shfrytëzojë të gjitha burimet e mundshme financiare p.sh.: përfitime financiare nga projektet ndërkombëtare, shërbimet për të tretët etj.</u></i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Sipas gjetjeve në RVB (Evidenca 90, Dokumenti nr. 16, Evidenca 93 Dokumenti nr. 21, Evidenca 120, Dokumenti nr. 60), FF ka hartuar dhe zbaton të gjitha procedurat e nevojshme për një ecuri normale dhe të plotë të ciklit akademik. Procedurat dhe rregulloret janë hartuar jo vetëm bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe Aktet nënligjore të tij, por edhe në kërkesat e Ligjit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>Arsimit Të Lartë në Republikën italiane duke qenë se kemi të bëjmë me një program të përbashkët me Universitetin e Barit. Të gjitha hapat që përfshijnë regjistrimin e studentëve (Evidenca 160, Dokumenti nr. 97), transferimin (Evidenca 115, Dokumenti nr. 55), ndjekjen e programit deri në diplomim (Evidenca 13, Dokumenti nr. 71) janë sanksionuar jo vetëm në Statutin e UKZKM, rregulloren e FF por edhe në rregulloret specifike të cituara më lart.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se FF zbaton politika dhe procedura të barabarta për të gjithë studentët, me rregulla transparente dhe të njohura nga të gjithë studentët nëpërmjet informimit nga stafi ose drejtpërdrejt nga faqja zyrtare e UKZKM. Në këtë aspekt GVJ vëren se studentët informohen rregullisht nga Koordinatori Programit (staf akademik i brendshëm) siç rezultoi nga vetë ata gjatë takimit midis GVJ dhe studentëve (Evidenca 111, Dokumenti nr. 53). Ata kanë llogaritë e tyre personale në sistemin elektronik të UniMS dhe kanë të drejtën e ankimimit për rezultatin e provimit (Evidenca 142, Dokumenti nr. 77). Gjithashtu, studentëve u jepet vazhdimisht mundësia për të ndjekur programe të mobiliteteve.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit për gjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në takimet me studentët e FF, theksojmë se studentët kontaktin e parë për informacionet lidhur me programin e studimit, regjistrimin, transferimin e studentëve, diplomimin etj, e marrin nëpërmjet faqes zyrtare të UniKZKM (https://unizkm.al/). Informacione më të detajuara rezultojnë të sigurohen nga afishimet në sekretarinë mësimore dhe fletëpalosjet apo guidat e ndryshme.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit</p>	<p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve vijnë në përgjigje të kërkesës së MASR. FF (referuar RVB, (Evidenca 165, Dokumenti nr.104) harton kriteret për pranim një vit më parë dhe përfshin në kuotat e parashikuara kandidatë nga trojet, nga shtetet e tjera etj.</p> <p>Për të aplikuar studentët mund të përdorin edhe adresën http://admissions.unizkm.al</p>




dhe udhëzimeve përkatëse.									
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ vëren se hartimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike të Programit të Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” janë në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 468, VKM-në përkatëse (kriteri i notës mesatare për pranimin e kandidatëve) dhe maturën shtetërore. Sipas RVB në kuotat e pranimit përfshihen jo vetëm kandidatë brenda vendit, por edhe nga trojet si edhe shtetas të huaj. (Evidenca 157, Dokumenti nr. 93; Evidenca 158, Dokumenti nr. 94; Evidenca 159, Dokumenti nr. 95)								
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UniKZKM referuar RVB, dëshmon se çdo fillim viti akademik organizon ditët e informimit për nxënësit e shkollave të mesme” për gjimnazistët dhe prindërit e interesuar. Në këto takime marrin pjesë pedagogë dhe studentë nga degë të ndryshme, në bashkëpunim edhe me Drejtoritë Arsimore Rajonale. Gjithashtu për këtë qëllim shërben edhe Panairi i Arsimit i organizuar nënkujdesin e MASR apo aktivitete të Ambasadës Italiane në Shqipëri dhe të shtrira edhe në rajone të tjera të vendit me temë si të studioni në Itali.								
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se UKZKM para fillimit të çdo viti akademik shpall kriteret e pranimit për çdo program studimi (Evidenca 165, Dokumenti nr.104). Shpalljet e kriterëve i referohen kandidatëve shqiptarë, atyre të huaj si dhe atyre që kërkojnë të transferojnë studimet e tyre në UniKZKM.								
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë	Në faqen zyrtare të UKZKM janë të shpallura edhe kriteret për fitimin e bursës së studimit dhe masën përkatëse të saj								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Asnjë përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Asnjë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Asnjë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Mbështetur në RVB dhe takimet me studentët si dhe informacionin e publikuar në ëbsite-in https://unizkm.al, rezulton se FF vë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret dhe procedurat akademike. Këtu përfshihen plani i studimit (evidenca 106, Dokumenti nr. 47), planet mësimore të viteve të fundit, numri i krediteve i nevojshëm për të kaluar nga njëri vit akademik në tjetrin, syllabuset e lëndëve të përditësuara etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ vëren se në përputhje me Rregulloren e Fakultetit (evidenca 90 Dokumenti nr.16) dhe Statutin e UKZKM. FF ngrre komisione të ekuivalentimit të lëndëve për të realizuar të gjitha procedurat e nevojshme të transferimit të studimeve për studentët që kanë kualifikime nga studimet e mëparshme.</p> <p>GVJ vëren (referuar Tabelës së Sekretarisë mësimore në RVB) se gjatë vitit akademik 2015-2016 ka patur tre studentë të transferuar, ndërsa gjatë viteve akademike 2016-2020 nuk ka patur transferime dhe në vitin akademik 2020-2021 ka vetëm një student të transferuar.</p> <p>Transferime bëhen më shumë në të kundërt, nga Programi i Farmacisë drejt programit të Mjekësisë të të njëjtit univesitet e kryesisht nga ana e studentëve të huaj.</p> <p><i>GVJ sugjeron që Institucioni, të bëjë përpjekje për uljen e numrit të studentëve të transferuar nga farmacia drejt programeve të tjera, pasi duke u ulur numri i studentëve të viteve pasardhëse sjell uljen e të ardhurave të këtij programi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacionet në lidhje me procedurat e vlerësimit të lëndëve jepen në mënyrë të plotë në syllabuset e lëndëve (Evidencat 114, 115 116 Dokumentat nr. 54,54.1,54.3). Nëpërmjet syllabuseve studentët mund të informohen në lidhje me kreditet e lëndëve, mënyrën e vlerësimit, kryesisht provim, temat e leksioneve apo të punëve laboratorike aty ku ka.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UKZKM-së, të FF, dhe Rregulloren e programit të studimit (Evidenca 93, Dokumenti nr.21) rezulton se studentët informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat e diplomimit. Gjetje të tilla u konstatuan edhe gjatë takimit me vetë studentët. Studentët kanë kontakte të rregullta me Koordinatorin e</p>

Adresa: "Ruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	informativ UniMS. Bashkëbisedimet me studentët gjatë takimit në institucion konfirmuan këto gjetje.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në RVB dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion, IAL deklaron se po punon për mbështetjen institucionale të studentëve për orientimin drejt karrierës dhe tregut të punës (Evidenca 92, dokumenti nr. 18), dhe ka marrë pjesë në Panairin e Punës ku studentët mund të njihen me informacione për punësim dhe punëdhënës të ardhshëm të mundshëm. <i>GVJ sygjeron në kuadër të strategjisë afatgjatë, programi i studimit duhet të përcaktojë edhe përshtatshmërinë me kërkesat e tregut.</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjetjet e GVJ janë se studentët e FF nëpërmjet faqes zyrtare të UKZKM (https://unizkm.al), sistemit të menaxhimit të informacionit UniMS, sekretarisë mësimore si dhe stendave të informacionit marrin informacion të përditësuar dhe të gjerë mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Referuar RVB, GVJ vëren se FF nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit UniMS, u jep studentëve mundësinë të kenë akses mbi informacione të ndryshme në lidhje me programin e studimit. Studentët janë të pajisur me kode personale nëpërmjet të cilëve mund të marrin informacion për lëndët e tyre, pikët e provimeve, notat etj.			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																												
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 si dhe Statutit të IAL sanksionohet ruajtja e dokumentacioni mësimor dhe baza e të dhënave të studentëve, GVJ konstaton se FF nëpërmjet sekretarisë mësimore disponon në formë të shkruar, regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e të dhënave akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave (Evidencat 153,154,155, përkatësisht Dokumentat nr.89,89.1,89.2)</p> <p>Institucioni arkivon rregullisht të gjitha rezultatet e të nxënit, si në hard copy, ashtu dhe në formë elektronike. Gjatë vizitës në institucion dhe sipas (evidencës 169 Tabelat Përmbledhëse, tabela nr. 24), numri i studentëve për një cikël studimi rezultoi:</p> <table border="1"><thead><tr><th>Viti akademik</th><th>Te regjistruar per here te pare</th><th>Te transferuar sipas brezave</th><th>Totali</th></tr></thead><tbody><tr><td>2016-2017</td><td>43</td><td>-</td><td>43</td></tr><tr><td>2017-2018</td><td>24</td><td>-</td><td>24</td></tr><tr><td>2018-2019</td><td>47</td><td>-</td><td>47</td></tr><tr><td>2019-2020</td><td>66</td><td>-</td><td>66</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>45</td><td>1</td><td>46</td></tr><tr><td>Totali</td><td>225</td><td>1</td><td>226</td></tr></tbody></table>	Viti akademik	Te regjistruar per here te pare	Te transferuar sipas brezave	Totali	2016-2017	43	-	43	2017-2018	24	-	24	2018-2019	47	-	47	2019-2020	66	-	66	2020-2021	45	1	46	Totali	225	1	226
Viti akademik	Te regjistruar per here te pare	Te transferuar sipas brezave	Totali																										
2016-2017	43	-	43																										
2017-2018	24	-	24																										
2018-2019	47	-	47																										
2019-2020	66	-	66																										
2020-2021	45	1	46																										
Totali	225	1	226																										
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Gjithastu referuar RVB dhe takimeve në institucion me sekretarinë mësimore rezulton se kjo sekretari bazuar edhe në rregulloren e saj (Evidenca 146, Dokumenti nr.81) arkivon dosjet e regjistrimit të studentëve, dosjet e transferimeve dhe të programeve të dyta të studimit etj.</p>																												
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga	<p>Në sekretarinë mësimore arkivohen gjithashtu edhe largimet e studentëve para përfundimit të programit si edhe studentët, të cilët nuk e përfundojnë me sukses programin e studimit, studentët që</p>																												

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


pranimi, deri në diplomimin e tyre.	çrregjistrohen etj. Në arkivim përfshihen edhe procesverbalet e provimeve të studentëve.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Referuar RVB dhe takimeve në institucion me sektorin e IT, u dëshrua se sistemi i menaxhimit të informacionit UniMS, mundëson përveç të tjerave një platformë dixhitale, e cila u ofron studentëve dhe stafit të kenë informacion të plotë dhe transparent të procesit mësimor. Nëpërmjet kësaj platforme sigurohen statistika të plota të numrit të studentëve përgjatë vitit akademik, përfshirë këtu edhe studentët që nuk arrijnë ta përfundojnë vitin akademik.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Bazuar në RVB, IAL ka hartuar Raportin Vjetor ku janë përfshirë veprimtaritë mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve të studimit. Pjesë e këtij raporti është edhe raporti i FF, i cili përfshin informacion edhe mbi shkallën e cilësinë e punësimit të të diplomuarve. <i>Në këtë kontekst, GVJ vëren se gjurmimi i punësimit të studentëve është bërë nga FF, gjithësesi ai duhet të jetë periodik dhe i vazhduar</i> <i>GVJ mendon se institucioni duhet të ketë të dhëna për studentët e tij edhe nga QSHA mbi përqindjen e studentëve të tij që e kalojnë Provimin e Shtetit që herën e parë duke qenë se profesioni i farmacistit bën pjesë në profesionet e rregulluara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	Bazuar në RVB, IAL / FF në përputhje me nenin 99 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në RSH si dhe Statutin e UKZKM (Evidenca 89, Dokumenti nr.15), angazhon studentët në organet vendimmarrëse. Përfaqësuesit zgjidhen me votë nga vetë studentët dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>konkretisht, ka përfaqësues në Senatin Akademik të UKZKM, në Këshillin Studentor, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Përfaqësuesi në Këshillin Kombëtar të Studentëve zgjidhet nga anëtarët e Këshillit Studentor. (Evidenca 165, dokumenti nr.104)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>E drejta e studentëve për të marrë pjesë në vendimmarrjet apo në nivel këshillimi ushtrohet edhe nëpërmjet pyetësorëve që Institucioni organizon çdo vit ku studentët shprehen mbi cilësinë e programeve, mbi mësimdhënien, pedagogët, infrastrukturën etj. Ky fakt u konfirmua edhe gjatë takimeve me Zyrën e Statistikave dhe me vetë studentët. Referuar takimeve në institucion me studentët, me stafin akademik dhe me zyrën e kurrikulave nuk ka patur deri më sot ndonjë ndryshim të ndodhur si pasojë e rezultateve të pyetësorëve të studentëve.</p> <p>Për të tejkaluar vështirësitë që studentët hasin si rrjedhojë e ngarkesës së shtuar në periudha të caktuara apo në lidhje me gjuhën PAE shqiptare bëjnë një punë mbështetëse me konsultime si dhe duhet marrë parasysh që në fund të studimeve këta studentë pajisen me një diplomë të dyfishtë UKZKM dhe UniBa.</p> <p>Përsa më sipër, GVJ konkludon se studentët e UKZKM/FF janë të përfshirë në struktura të rëndësishme vendimmarrëse të jetës akademike, por duhet bërë më shumë për reflektimin e propozimeve të tyre konkretisht në jetën studentore.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në përputhje me VKM Nr.41, dt.24.01.2018, pika 2.1/d, rezultojnë se FF ka parashikuar në Planin Mësimor (evidenca 106, Dokumenti 47) dhe Orarin Semestral se studenti duhet të ketë jo më shumë se 20-25 orë/javë në auditor.</p> <p>Gjithashtu, për studentët që ri-fillojnë studimet pas një periudhe shkëputje, FF ka përcaktuar në Rregulloren e tij dhe Rregulloren e programit mësimor (Evidenca 93, Dokumenti nr.21) të gjitha procedurat përkatëse për njohjen e arritjeve akademike të mëparshme (Evidenca 161, Dokumenti nr.98). Në një rregullore më vehte parashikohen edhe vlerësimi i arritjeve të studentëve të regjistruar, të cilët janë diplomuar në një program të mëparshëm (Evidenca 160, Dokumenti nr.97).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në</p>	<p>Referuar takimeve në institucion si dhe gjetjeve në RVB, rezultojnë se FF ka krijuar mekanizmat e duhur të komunikimit për përfshirjen e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>mendimit të studentëve në proceset e vlerësimit të didaktikës, por ende nuk ka ndonjë shembull konkret që ndikimit të mendimit të tyre në hartimin, rishikimin apo përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>Konkretisht, Koordinatori akademik realizon në mënyrë të rregullt takime me studentët. Studentët mund të japin mendime për programin e studimit, lëndët apo përmirësimin e syllabuseve gjatë plotësimit të pyetësorëve të zhvilluar nga UniZKM. Gjithashtu, Këshillat Studentorë mund të japin mendimet e tyre me shkrim për çështje të ndryshme lidhur me përmirësimin e programit.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton, se procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë këtu edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit nga ana e studentëve është i sanksionuar në të gjitha rregulloret e IAL (Rregulloren e universitetit, Fakultetit të Farmacisë dhe të programit të studimit, Evidencat 89, Dokumenti nr.15; Evidenca 90, Dokumenti nr. 16 Evidenca 93 Dokumenti nr.21).</p> <p>Referuar RVB dhe takimeve me studentët, studenti mund të kërkojë ankimim për rezultatin e provimit. (Evidenca 142, Dokumenti nr. 77) Ankimimi i dorëzohet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit, i cili vë në dijeni Dekanin. Ky i fundit ngre komisionin <i>ad hoc</i>, i cili verifikon pretendimet e studentit/tes.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbyhet</p>	<p>Përmbyhet pjesërisht</p>	<p>Përmbyhet kryesisht</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Duke qenë një program studimi dygjuhësh që ofrohet nga Fakulteti i Farmacisë, UKZKM në bashkëpunim me Departamentin e Farmacisë-Shkencave të Barnave të Universitetit të Barit në përputhje me Marrëveshjen e nënshkruar (Dokumenti nr.5) si rrjedhojë vërehet edhe një shkëmbim të ndërsjellë në fushën e kërkimit shkencor. Stafi akademik shqiptar dhe ai italian bashkëpunojnë për kërkime të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>ndryshme shkencore apo përgatitjen e punimeve dhe artikujve të ndryshëm të paraqitura në konferenca e aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. (dokumenti nr.105)</p> <p>Një evidencë mbështetëse në lidhje me këtë argument përbën edhe CV e secilit prej pedagogëve të brendshëm të FF/UKZKM.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>IAL ka marrëveshje bashkëpunimi shkencor-didaktik me Universitetin e Barit Aldo Moro (Dokumenti 5). Gjithashtu Zyra e Projekteve Kërkimore dhe Formuese informon dhe përditëson të gjitha strukturat e Universitetit mbi programet e ndryshme dhe thirrjet për projekte kërkimore (Dokument nr. 63), dhe formuese (të financuara në nivel Universiteti, nivel kombëtar, rajonal, evropian dhe ndërkombëtar) dhe mbi mënyrat përkatëse të pjesëmarrjes. Për më tepër, Zyra ndihmon në përgatitjen, prezantimin, menaxhimin, monitorimin, zbatimin, raportimin dhe shpërndarjen e këtyre projekteve (Dokumenti nr.64). Pjesëmarrja në projekte dhe aktivitete kërkimore lehtësohet gjithashtu falë rrjeteve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit institucional (Dokumenti nr. 65), si dhe kontakteve e rrjeteve të Universitetit partner dhe secilit kërkues shkencor, si dhe gjenerimit të nismave të reja të përbashkëta.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe takimeve në institucion, GVJ vëren se studentët mbështeten përsa i përket diskutimeve, punës në grup interpretimit, zgjidhjes së problemeve të caktuara, <i>por nuk bëhet për nxitjen e tyre që të zhvillojnë një punim shkencor të mirëfilltë apo temë eksperimentale për diplomim. Në këtë kuadër IAL duhet të punojë më shumë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ nuk ka evidencë në lidhje me publikime apo prezantime të përbashkëta mes stafit akademik dhe studentëve në revista shkencore ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>GVJ vëren se bazuar në RVB dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion nuk ka evidencë në lidhje me ndonjë studim inovativ apo patentë të studentëve të FF/UKZKM.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik</p>	<p>Bazuar në RVB si dhe nga vizita në institucion GVJ vëren se studentët</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” e përfundojnë ciklin 5-vjeçar me temë diplome e cila mund të jetë shtjelluese ose eksperimentale.</p> <p>Mirëpo rezultojnë se pak studentë zgjedhin temën eksperimentale për shkak se mund të vonohet në kohë diplomimi i tyre në krahasim me kolegët që kryejnë një temë kompilative. Sido që të jetë ata ndiqen nga 2 pedagogë, udhëheqësi dhe bashkëudhëheqësi që zakonisht janë një i huaj dhe një vendas. Tema bibliografike zhvillohet me mbledhjen e materialeve dhe përpunimin e tyre ndërkohë që ajo eksperimentale zhvillohet në laborator, zakonisht në Universitetin e Barit. Në të dy rastet studentët mbikëqyren dhe ndihmohen nga personeli akademik si gjatë analizave, përpunimeve të rezultateve e deri në mënyrën e prezantimit. Në këtë kuadër GVJ mendon se duke qenë se tema e diplomës është një nga punët më domethënëse të studentëve gjatë 5 viteve të studimeve universitare, pasi nëpërmjet tyre studentët do të kenë mundësinë të provojnë konkretisht në vetën e parë se si zhvillohet një kërkim shkencor, siç është përmendur edhe më sipër institucioni duhet të gjejë mënyrat dhe të nxisë studentët drejt temave eksperimentale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi V.7</p>	
<p>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit</p>	<p>Bazuar në RVB UniKZKM ka një Zyrë të veçantë të Projekteve Kërkimore dhe Formuese e cila informon studentët dhe stafin mbi programet dhe mundësitë e mobilitetit qoftë në kuadrin e studimeve, praktikave apo kërkimit shkencor. Ky informim realizohet edhe me material informues apo me aktivitete të dedikuara si ditët e informacionit që zhvillohen në godinën e universitetit.</p> <p>Megjithatë GVJ vëren me keqardhje se deri tani asnjë student i FF nuk</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	ka përfituar nga program ERASMUS +, gjë që nga vizita në institucion rezultoi se është një nga objektivat e tij për të ardhmen.			
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Bazuar në RVB si dhe nga takimet në institucion rezulton se kusht paraprak për studime pasuniversitare është të ketë zhvilluar temë eksperimentale, studentë këta që janë të trajnuar dhe që kanë marrë pjesë në aktivitete kërkimore laboratorike etj.			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore.	Pogrami i Studimit Master i Shkencave në "Farmaci" është një program dygjuhësh. Bahkëpunimi me Universitetet partnere italiane, qoftë UniMI, qoftë UniBA ka sjellë mundësinë e kërkuesve të rinj shqiptarë për t'u përfshirë në grupe kërkimore shkencore me studiues italianë, një mundësi e mirë kjo për transferimin e njohurive dhe kompetencave tek brezi i ri. Një pjesë e tyre sot janë staf akademik i brendshëm i FF në UniKZKM, bëjnë pjesë në organizata ndërkombëtare etj.			
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	UniKZKM/FF promovon proceset e bashkëpunimit dhe integritit nëpërmjet profesorë e të huaj dhe studiuesve që kryejnë aktivitete didaktike dhe kërkimore në programin e studimit farmaci. Për sa më sipër përmendim lektorët e lëndëve të ndryshme që janë të kombinuar italianë dhe vendas, po kështu udhëheqjet e diplomave, komisionet e provimeve etj.			
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Në kuadrin e ndërkombëtarizimit të këtij institucioni vlen të përmendet praktika profesionale e studentëve të farmacisë që me mbështetjen e institucionit kryhet nga të gjithë studentët 3 muaj në farmacitë italiane e 3 muaj në ato vendase, ndërsa në lidhje me programet e mobilitetit megjithë përpjekjet nuk ka ende asnjë student që të ketë përfituar.			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Për vetë specifikën dygjuhëshe që ka ky Universitet stafi akademik i huaj është pjesë e përherëshme e tij. Studentët e huaj që vijnë në kuadrin e programeve të mobilitetit përzgjidhen nga universitetet e tyre dhe zhvillojnë aktivitetet e dakordësuara më parë midis dypalëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


			X	
--	--	--	---	--

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Bazuar në RVB dhe nga informacionet e mbledhura gjatë takimeve në institucion mund të thuhet se UKZKM në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloren e IAL si dhe rregulloren e FF vë në shërbim të studentëve Koordinatorin e programit të studimit e dedikuar për t'u dhënë atyre çdo shpjegim apo informacion në lidhje me të. Studentët mund të marrin informacionet e nevojshme nga burime të ndryshme si nga faqja zyrtare e IAL, në sekretarinë mësimore, në zyrën e këshillimit të karrierës etj.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Bazuar në RVB dhe në takimet në institucion rezulton se UKZKM ka një sistem informimi dedikuar studentëve, StudentAPP. Nëpërmjet këtij sistemi studentët marrin informacione të ndryshme si frekuentimin, vlerësimin në provimeve, programin e studimit, oraret dhe sallat e zhvillimit të leksioneve, seminareve apo laboratorëve.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të	Referuar RVB dhe gjetjeve gjatë vizitës në IAL rezulton se UKZKM ka të ngritur dhe funksionale Zyrën e Këshillimit të karrierës dhe ALUMNI. Kjo zyrë angazhohet qysh me promovimin e Institucionit tek maturantët, më pas orientimin e studentëve për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën profesionale si dhe mundësitë e ndryshme të punësimit. Kjo zyrë është një ndërmjetëse midis ofruesve të vendeve të punësimit dhe studentëve të UKZKM//FF.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumni pranë UKZKM ka një database pothuajse të plotë mbi studentët e diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci”. Zotëron të dhëna të sakta mbi shkallën e punësimit të tyre brenda ose jashtë vendit si dhe nëse janë punësuar në përputhje me fushën e diplomimit. Nga të dhënat vihet re se 93.6% e të diplomuarve punësohen në përputhje me diplomën, kurse për 4.7% nuk ka të dhëna. (Referuar RVB Tabela 23)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore	Sipas RVB, IAL në zbatim të LAL Nr. 80/2015 pika 1, ka ngritur struktura në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Këto struktura IAL, i ka të parashikuara në Statut (Evidenca 89, Dokumenti nr. 15). Gjithashtu, GVJ konstanton se IAL ka ngritur Njësinë e vlerësimit të cilësisë (Evidenca 167, Dokumenti nr. 110), e cila funksionon mbi bazën e një rregulloreje (Evidenca 168, Dokumenti nr. 112). Bazuar në evidencat mbështetëse të RVB, GVJ konstanton se

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>institucionale.</p>	<p>IAL ka hartuar formularë në formën e pyetësorëve për studentët në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik, ndihmës akademik etj. (Evidenca 123, Dokumenti nr. 66; Evidenca 124, Dokumenti nr. 66.1). GVJ vlerëson se IAL ka ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar strukturat dhe procedurat e nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, por sygjerojmë që këto struktura të shtrihen edhe në nivelet e tjera, njësi kryesore dhe njësi bazë.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion u deklarua se studentët marrim pjesë në anketime të ndryshme duke iu përgjigjur formularëve përkatës në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit. Gjithsesi GVJ konstaton se nuk ka të dhëna se sa kanë ndikuar këto analiza statistikore në ndërmarrjen e veprimeve konkrete që reflektojnë kërkesat e studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë UKZKM ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBC) e cila është vënë në zbatim të strategjisë së IAL dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies (Evidenca 167, Dokumenti nr. 110). Njësia ka në përbërjen e saj edhe studentë.</p> <p><i>GVJ nuk gjeti asnjë evidencë për ngritjen ose funksionimin (në rast se janë formuar) e këtyre njësive në bazë fakulteti apo departamenti. <u>GVJ sugjeron</u> se është e nevojshme ngritja e NJSBC të paktën në nivel fakulteti, ose në të kundërt IAL mund/duhet të hartojë dhe të vërë në zbatim Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik. Në këtë manual duhet të përshkruhen qartë të gjitha procedurat, shkallët dhe elementët e vlerësimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e</p>	<p>Në funksion të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UKZKM ka realizuar me sukses vlerësimin e jashtëm institucional. Vlerësimi i jashtëm është kryer me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standardeve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë së këtij institucioni. Proçesin e Akreditimit Institucional si dhe atë të programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” IAL e ka përfunduar me një vlerësim pozitiv me një kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite akademike (Evidenca 83, Dokumenti nr. 7; Evidenca 84, Dokumenti nr. 8).</p> <p>Si një program i përbashkët që ofrohet në bashkëpunim me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përmirësojnë cilësinë.	Universitetin "Aldo Moro" në Bari, ky program studimi është i akredituar edhe në shtetin italian me maksimumin e vlerësimit. Ky vlerësim dëshmon se UKZKM zotëron dhe përdor instrumentet e duhura për përmbushjen e standardeve, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, IAL ka ngritur Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Evidenca 167, Dokumenti nr. 110). Gjithashtu, IAL ka parashikuar në Statutin (Evidenca 89, Dokumenti nr. 15) dhe Rregulloren (Evidenca 168, Dokumenti nr. 112) e saj procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Gjithashtu bazuar në RVB, GVJ konstaton se IAL ka ngritur edhe Komisionet për Vlerësimin e brendshëm të cilësisë në nivel Program studimi (Evidenca 85, Dokumenti nr. 9).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.	Referuar RVB, bazuar edhe në vizitën në institucion GVJ vëren se në funksion të monitorimit, shqyrtimit dhe rishikimit të programit DIND, UKZKM ka ngritur njësi si Zyra e Kurrikulave dhe vlerësimit të cilësisë. Në shërbim të përmirësimit të programit funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional. IAL ka ngritur edhe Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në nivel program studimi (Evidenca 85, Dokumenti nr. 9). <i>GVJ sygjeron se në kuadër të ndryshimeve në masën 20%, për ngritjen e cilësisë së programit, FF të zgjerojë një nga lëndët si "Analizë e kontroll barnash" apo "Përgatitje galenike në laborator", duke bërë</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

	<p><i>të mundur që studentët të jenë të aftë të punojnë në sektorët analitikë publik apo privat qysh me përfundimin e studimeve universitare.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në bazë të RVB, GVJ vëren se UKZKM/FF ka vënë në zbatim mekanizma dhe procedura të dokumentuara për shqyrtimin apo mbikëqyrjen e programeve të studimeve. Në këtë kontekst, IAL ka hartuar raportin vjetor në nivel institucioni ku përfshihen analizat e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. FF vë në zbatim procedurat për ndryshime në programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci” referuar jo vetëm LAL, VKM dhe Udhëzimeve përkatëse, por edhe ndryshimeve të bëra nga FF UniBA dhe të aprovuara e akredituara nga Ministria Italiane e Arsimit, Agjensia respektive e Akreditimit ANVUR. Në këtë kuadër theksojmë se programi aktual i studimit ka fituar një projekt INNOFARMA 18 (IF18) si programi më inovativ ndër universitetet e rajonit të Puglias.</p> <p>Gjithashtu, IAL ka hartuar pyetësonin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Këta pyetësorë përcillen tek studentët në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve. Gjatë vizitës në institucion nga takimi me Dekanin si edhe ai me studentët rezultoi se përveç pyetësorëve një praktikë e mirë është edhe mbledhja e përvitshme e organizuar nga Dekani i FF për diskutimin në një rreth të gjerë pedagogësh, studentësh dhe drejtues të institucionit në lidhje me aspektet e ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies apo aspekte të jetës studentore. Gjithësesi deri tani nga analizat e përfundimet e nxjerra nga pyetësorët e zhvilluar nuk ka rezultuar ndonjë masë e marrë për përmirësimin e kurrikulës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të hartimit të raportit vjetor në nivel institucionit, GVJ vëren se, NJVBC i përcjell Rektorit dhe Senatit Akademik analizën e situatës me informacione të detajuara në lidhje me numrin e përvitshëm të studentëve frekuentues, funksionimin e Këshillimit akademik, numrin e të diplomuarve, kalueshmërinë e studentëve, pyetësorët, ankesat e protokolluara të studentëve etj. (Evidenca 214, Dokumenti nr. 67). Raporti/analiza vihet në funksion të vlerësimit dhe mbarëvajtjes së programeve të studimeve.</p> <p>Në RVB deklarohet gjithashtu se NJVBC harton pyetësorët e studentëve në mënyrë periodike, rezultatet e të cilave iu dërgohen më pas Rektorit dhe Senatit Akademik. Referuar RVB, UKZKM në zbatim të statutit të tij realizon çdo vit akademik vlerësimin e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>performancës së personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet plotësimit të formularëve të vetëdeklarimit të pedagogëve. (Evidenca 147, Dokumenti nr. 82)</p> <p><i>GVJ rekomandon se vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës-akademik nuk duhet të bazohet vetëm në një element vlerësimi siç është formulari i vetëdeklarimit. Vlen të përmendet se NJSBC jo vetëm raporton në mënyrë periodike pranë Rektorit dhe Senatit Akademik por jep edhe rekomandimet e saj mbi praktikën e mira dhe aspektet që duhen përmirësuar.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, UKZKM/FF kanë vënë në zbatim Procedurën e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi. Në këtë kontekst, NJSBC përpilon Raportin e Analizës, propozimet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e cilësisë të programeve dhe mësimdhënies (Evidenca 214, Dokumenti nr. 67)</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Në vijim të vlerësimit tonë (Standardi VI.1, kriteri I) si dhe bazuar në RVB (Evidenca 214, Dokumenti nr. 67), ku pasqyrohet raporti mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve dhe analiza e tyre. FF pranë UKZKM ka zgjedhur përveç pyetësorëve edhe metodën e drejtëpërdrejtë të shqyrtimit të problematikave të mundshme nëpërmjet mbledhjes së hapur Dekan, staf akademik, studentë, që zhvillohet çdo vit dhe ku gjithkush mund të ngrejë shqetësime dhe propozojë zgjidhje mbi aspekte të ndryshme të programit, performancës apo jetës kulturore e sportive.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i</p>	<p>Në RVB deklorohet se vlerësimi i brendshëm i programit të studimit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>është kryer në mënyrë periodike nga FF. Në vlerësimin e brendshëm përfshihet edhe performanca e stafit akademik nëpërmjet sistemit të vlerësimit nga studentët (anketimeve). Vlerësimi i brendshëm i realizuar në nivel Fakulteti përfshihet në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p><i>GVJ vëren se nuk ka evidenca mbi funksioimin e plotë të vlerësimit të brendshëm të programit të studimi dhe punën e komisionit përkatës në lidhje me të.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se për kryerjen e vlerësimit të programit të studimit NJSBC përdor disa metoda duke filluar nga intervistat nëpërmjet postës elektronike, intervistat e thjeshta për sqarimin e pikave të paqarta, nëpërmjet bashkëpunimit me Koordinatorin e programit, i cili kryen edhe detyra tutoriati me studentët dhe është gjithmonë pranë tyre siç u deklarua edhe nga vetë studentët gjatë takimit në institucion. Gjithashtu një mënyrë vlerësimi janë edhe pyetësorët e studentëve pikat mbi programin mësimor apo performancën e pedagogëve etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, GVJ vëren (referuar RVB) se Koordinatori mësimor çdo fillim viti akademik në bashkëpunim me NJSBC dhe Zyrën e statistikave marrin në shqyrtim rezultatet e pyetësorëve elektronikë. Nga ana tjetër një vend të veçantë zë shqyrtimi i rezultateve të studentëve në provime, që bashkëngjitur me sa më sipër shërbejnë për të nxjerri konkluzionet mbi shkallën e realizimit dhe cilësinë e programit. Këto konkluzione iu bëhen me dije edhe personelit akademik. Gjithashtu, në funksion të mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit, UKZKM harton analizën vjetore (Dokumenti nr.67) dhe përfshin në të elementët matës të rëndësishëm siç janë, plotësimi i standarteve të ambienteve dhe didaktikës laboratorike, konkluzionet e pyetësorit të studentëve, plotësimin e standarteve të stafit akademik, kalueshmërinë dhe cilësinë semestrale etj,</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u kërkua nga GVJ një statistikë mbi kalueshmërinë e studentëve të UKZKM në provimin e shtetit gjë që nuk na u vu në dispozicion me arsyetimin se këto janë të dhëna konfidenciale të studentëve.</p> <p><i>GVJ sygjeron se Institucioni duhet ta ketë këtë statistikë si një evidencë</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>për të gjykuar mbi cilësinë e mësimnxënies së studentëve të këtij programi dhe për të reaguar në përputhje me të, nëse është e nevojshme të përmirësohet ndonjë aspekt i programit të studimit.</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Referuar RVB, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit IAL përdor disa metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi. Këtu mund të përmendim, informacionin e përpunuar prej Zyrës së Këshillimit të karrierës së studentëve dhe Alumni-it (https://unikzkm.al), realizimin e takimeve të përvitshme me ish-studentët prej nga merret informacion në lidhje me punësimin e studentëve dhe sektorët ku ata janë punësuar etj. Në RVB raportohen gjithashtu, në kuadër të vlerësimit, zhvillon edhe takime apo intervista formale dhe joformale me drejtues të institucioneve të ndryshëm, si Ndërrmarrja e prodhimeve Farmaceutike PROFARMA, farmacitë e rrjetit të hapur në Shqipëri dhe Itali, AKKBPM, etj. Këto takime janë vënë në funksion të njohjes me kërkesat e tregut të punës dhe pasqyrimin e tyre në kurrikulën e programit të studimit. <i>GVJ shpreh mendimin se FF ka ngritur instrumenta të tërthorta për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, por për të patur një rezultat bindës mund të kishte përdorur edhe mekanizma të tjerë.</i>			
Shkalla e përfshirjes së standardit	Përfshirja	Përmbashtet pjesërisht	Përmbashtet kryesisht	Përmbashtet plotësisht
			X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të	Referuar RVB, IAL ka parashikuar në Statut (Evidenca 89), Rregullore (Evidenca 90), Planin Strategjik 2017-2027 (evidenca 91), përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përsa më sipër, GVJ konstaton se në Statut, Rregullore dhe Planin Strategjik, IAL ka përcaktuar rolin dhe detyrat konkrete për njësitë, studentët dhe palë të tjera të përfshira për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ vëren gjithashtu, se një nga politikatat e institucionit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë konsiston në zhvillimin në mënyrë vazhdueshme të pyetësorëve nga ana e studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në Statutin e IAL (Evidenca 89) është parashikuar ngritja në nivel program studimi e Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë Brendshme. Në këto komisione është parashikuar, gjithashtu edhe pjesëmarrja e studentëve përveç trupës akademike.</p> <p><i>GVJ vëren se këto komisione janë krijuar siç edhe deklarohej në RVB. GVJ shpreh mendimin se mbetet për t'u parë roli aktiv i këtyre komisioneve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në zbatim të ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", GVJ konstaton se IAL ka respektuar lirinë dhe etikën akademike gjatë vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet strukturave përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, GVJ vëren (referuar takimeve në institucion) se gjatë plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit e realizuar nga studentët e çdo kursi është ruajtur anonimiteti dhe konfidencialiteti i tyre. Nuk raportohet të ketë patur raste që studentët apo pedagogët të ankohen për shfaqje të diskriminimit apo pabarazisë.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe përfshirjes në këtë vlerësim, edhe të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, IAL ka</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>organizuar takime të ndryshme.</p> <p>GVJ konstaton, organizimin e takimeve mujore ose edhe më shpesh midis Koordinatorit të programit dhe studentëve të viteve të ndryshme, takime vjetore për diskutimin e rezultateve të pyetësorëve me temë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor në të gjitha drejtimet. (Vizita në institucion, dokumenta shtesë). Takimi i përvitshëm zhvillohet me pjesëmarrjen e autoriteteve drejtuese të IAL-së, pedagogë, studentë, etj. Në fund të takimit propozohen rekomandimet për përmirësimin e programeve të studimit. (gjatë vizitës në institucion u pa edhe një kopje e proces verbalit të takimit të këtij viti).</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ vlerëson se IAL nëpërmjet faqes zyrtare, eëë.unizkm.al, pasqyron në mënyrë transparente dhe bën publike politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Përsa më sipër, publikimi dhe transparenca realizohen në kuadër të të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ vëren se NJSBC ka përpiluar Raportin e Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për çdo Lëndë të Programit të Studimit, të cilin e ka raportuar edhe në Standardin VI.5, Kriteri.2. Hartimi i Raportit të Analizës është në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”. Ky raport shoqërohet me një analizë përmblendhëse SWOT dhe publikohet duke ruajtur privatësinë dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	etikën akademike, si dhe legjislacionin mbi të dhënat personale konform Ligjit Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Referuar RVB, GVJ konstaton se krahas të Raportit të Analizës, NJSBC përpilon edhe projekt-propozimet si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Këto propozime përcillen në strukturat përkatëse bazuar në rregulloren përkatëse (Evidenca 214, Dokumenti nr.67). <i>GVJ sygjeron që përveç pyetësorëve të studentëve dhe formularëve të vetëdeklarimit të pedagogëve, do ishte me vlerë për ruajtjen dhe ngritjen e cilësisë së programit edhe zhvillimi i përvitshëm i një pyetësori anonim tek stafi akademik dhe ai ndihmës-akademik.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në RVB, GVJ vlerëson, se NJVBC është një pikë e fortë ku mbështetet puna për përmirësimin e vazhdueshëm të instrumentave të vlerësimit të cilësisë të Programeve të Studimit, por është e nevojshme ngritja e njësive përkatëse edhe në nivel fakulteti apo departamenti.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Bazuar në evidencat mbështetëse të RVB, GVJ vëren se IAL organizon takime periodike me personelin dhe studentët për t’i informuar në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin të cilësisë së programit të studimit. Këtu mund të përmendet plotësimi i pyetësorëve dhe pjesëmarrja në Sondazhin Kombëtar të Studentëve, publikimi i rezultateve përkatëse etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të Integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në: "FARMACI"

a. Pikat e forta dhe afirmime:


1. Përmbajtja e programit dhe mësimdhënia, që bazohet në programin e Universiteti të Barit (UniBa), i cili vlerësohet të jetë ndër programet më inovative në nivel rajonal dhe reflekton rëndësinë e profesionit të farmacistit në sistemin shëndetësor si dhe evoluimin e rolit të tij;
2. Bashkëpunimi me UniBa garanton një formim cilësor të studentëve të programit të integruar të studimit "Master i Shkencave në Farmaci" me standarde të nivelit të BE-së;
3. Të diplomuarit nga FF/UKZKM pajisen me një diplomë të njohur jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Itali dhe në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, gjë që u lejon atyre të praktikojnë apo punësohen në çdo vend anëtar të Bashkimit Evropian;
4. Stafi akademik është një kombinim harmonik jo vetëm i gradave dhe titujve akademikë, por edhe i moshave të ndryshme, gjë që nënkupton një vazhdimësi në kohë të cilësisë së mësimdhënies nga brezi në brez;
5. Aftësia e FF/UKZKM për transformimin e aktiviteteve online gjatë pandemisë COVID-19 në mënyrë adekuate, duke përdorur sisteme të përsosura të IT-së të nivelit të atyre që u përdorën në mënyrë universale, pothuajse në gjithë botën;
6. Burimet financiare nuk bazohen vetëm tek tarifat e studimit, kështu që stabiliteti financiar dhe asetet e pronave të patundshme në shërbim të UKZKM/FF është një siguri më shumë për vazhdimësinë e këtij programi studimi;
7. Objektivi afatgjatë i universitetit është që ta pavarësojë Fakultetin e Farmacisë UKZKM nga partneri i ngushtë (UniBa), përsa i përket mësimdhënies (pra të ketë rekrutim adekuat të stafit shqiptar) duke e ruajtur partneritetin, i cili padyshim i sjell benefite të mëdha UKZKM-së;

b. Pika të dobëta:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



1. Përfshirja e studentëve në kërkime shkencore është e ulët gjë që reflektohet me mungesën e përfshirjes së studentëve të programit të farmacisë në publikime apo prezantime në konferenca ndërkombëtare. Po në këtë kontekst mund të përmendet edhe fakti se mungon pjesëmarrja e studentëve të këtij programi studimi në programet e mobilitetit;
2. Transferimi i studentëve nga Programi i Farmacisë drejt programit të Mjekësisë është i lartë, pothuajse alarmues, pasi mund të sjellë një numër problemesh, si planifikimi i mësimdhënies nga vitit në vit, planifikimi i buxhetit, ulja e motivimit tek studentët që vijnë në programin e Farmacisë deri në përfundim, etj;
3. Nuk ndiqet një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe pjesëmarrja, sidomos e stafit shqiptar, në konferenca cilësore ndërkombëtare është tejet e limituar. Po ashtu, nuk ka shembuj të mjaftueshëm të aplikacioneve për grante më të mëdha (p.sh.: Horizon 2020, etj.);
4. Bashkëpunimet me institucione të tjera shkencore, sidomos universitete në nivel ndërkombëtar janë të limituara, përveç bashkëpunimit shumë të afërt me UniBa i cili vlerësohet padyshim;
5. Procedurat dhe politikat institucionale për matjen dhe vlerësimin e zhvillimit dhe ecurisë së programit të studimit, diplomimit dhe daljes në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve janë të pamjaftueshme, për të patur një rezultat bindës, nuk zhvillohen periodikisht e në mënyrë të vazhduar;

Rekomandime

1. Rekomandojmë që Fakulteti i Farmacisë të zbatojë politika më nxitëse dhe lehtësuese për përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore, të rritet numri i studentëve që zhvillojnë një punim shkencor të mirëfilltë apo temë eksperimentale për diplomim duke u ofruar kohëzgjatje identike dhe kriteret të ngjashme vlerësimi me ato kompilative;
2. Të bëhen përpjekje për uljen e numrit të studentëve të transferuar nga farmacia drejt programeve të tjera, në mënyrë që të evitohen problemet potenciale, ku një nga metodat mund të ishte kryerja e një interviste në praninë, fokusuar në motivimin për të studiuar farmacinë;
3. Të rritet përfshirja e studentëve në përmirësimin e programit, duke krijuar mekanizma specifik për të marrë 'feedback' të vazhdueshëm nga studentët (përveç takimeve me koordinatoren) si dhe mekanizma për implementimin e tij;
4. Me qëllim ruajtjen dhe ngritjen e mëtejshme të cilësisë së programit rekomandojmë që strukturat përgjegjëse t'i forcojnë mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse të stafit, p.sh.: duke përfshirë edhe vlerësimin e mësimdhënies nga

kolegët. Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës-akademik nuk duhet të bazohet vetëm në një element vlerësimi siç është formulari i vetëdeklarimit;

5. Rekomandojmë që mbështetja e personelit e akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike të jetë më e konsiderueshme duke ofruar p.sh.: kurse intensive të pedagogjisë dhe metodave inovative të mësimdhënies dhe suportit të studentëve. Kjo vlen sidomos për stafin e ri akademik;
6. Të forcohet politika e kërkimeve shkencore, të ngrihen mekanizma për vlerësimin e ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe pjesëmarrja, sidomos e stafit shqiptar, në konferenca cilësore ndërkombëtare;
7. Të rritet niveli i rëndësisë së detyrave të kursit në vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve, me ndikim në vlerësimin përfundimtar të tyre;
8. Të përmirësohet më tej niveli i bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare si dhe organizmat shkencorë kombëtarë përtej bashkëpunimit me universitetin partner;
9. Të merren masa që NJSBC të ketë të paktën një përfaqësues në nivel departamenti ose të vihet në zbatim Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik. Në këtë manual duhet të përshkruhen qartë të gjitha procedurat, shkallët dhe elementët e vlerësimit;
10. Të përmirësohen politikat dhe proceset e vlerësimit të zhvillimit dhe ecurisë së programit të studimit, diplomimit dhe daljes në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve;

Summary analysis of the study program Master of Sciences “Pharmacy”

a. Strengths and affirmations:


1. The programme content and teaching is based on the programme of the University of Bari (UniBa), which has been evaluated as one of the most innovative programmes in Puglia region and reflects the importance of pharmaceutical profession in the health system;
2. Collaboration with University of Bari, Italy guarantees to students of this programme of study “Master of Sciences in Pharmacy” quality and european standards;
3. Diplomants of study program Master of Sciences “Pharmacy” by Faculty of Pharmacy/“Catholic University of the Lady of Good Council” gain a diploma recognized

not only in Albania, but also in Italy and EU which permits them to practice and work in every country, member of European Union;

4. The good combination of academic staff from grades and academic titles point of view, as well as from age and gender one assures a continuation of qualitative teaching in the years to come;
5. The ability and promptness of Faculty of Pharmacy, OLGCU, in transforming the academic activities "online" during COVID-19 pandemic period, using the same high quality IT systems the same as quite all over the world;
6. Financial stability which derives from the fact that financial sources of this programme are not based 100% on tuition fees. Property assets at disposal of OLGCU/F.Ph. are an additional assurance for the continuity of this study programme;
7. Longterm objective of the University is to make possible that Faculty of Pharmacy, "Our Lady Of Good Council" University, become independent from its close partner University of Bari, as far as it concerns teaching (recruiting more albanian academic staff) conserving partnerity, which undoubtedly brings a lot of benefits for OLGCU;


b. Weakness:

1. Involvement of students in scientific research is low, which reflects in absence of their participation in publications or presentations in international conferences. In this context it's worthy to mention the fact that no one of the students of this program has participated in mobility program;
2. Students transfer from MSc in Pharmacy program into that of Medicine is high, quite alarming, because it might bring a problems with teaching planning from year to year, budget planning, might decrease the motivation of students continuing the pharmacy program to the end, etc;
3. There is no evidence of a policy of intelectual property protection and the participation of academic staff, especially the albanian one, in international conferences is very limited. In the same point there is not enough evidence of applications for big grants as it is Horizon 2020 for example;
4. Even the close collaboration with UniBa is very appreciated, collaborations with other scientific institutions, national and international ones, are very limited;
5. Institutional politics and procedures to evaluate the advancement of the study program, students' graduation and their insertion to the work market or higher level studies are insufficient to give conclusive results, lack periodicity and continuity;



Recommendations

1. It is recommended to increase the involvement of students in scientific research, increase the number of students choosing experimental thesis for graduation offering them the same Time Length and evaluation criteria with elaborated ones;
2. It is recommended to the institution to take measures to decrease the number of students' transferring their studies from pharmacy program into other programs, in order to prevent potential future problems, using methods like interviewing candidates focusing on their motivation to study pharmacy;
3. Increase involvement of students in study program improvements, creating specific mechanisms to get continuing "feedback" (apart from routine meetings with program coordinator) and implement it;
4. In order to maintain and increase further more the quality of the program it is recommended to improve monitoring and evaluation of teaching skills mechanisms, including evaluation from colleagues as well;
5. It is recommended to increase the support to the academic staff in improving didactic competencies, offering for example intensive courses on didactic skills or on the application of innovative teaching methods and students' support, especially to young academic staff;
6. It is recommended to strengthen politics and improve mechanisms on the evaluation of the outcome of scientific research, increase the evidence of the institutional policy for intellectual property protection and the participation of academic staff especially the albanian ones, in international conferences;
7. There should be increased the value of course duties made by students in their continuing evaluation and especially the final one;
8. Improve furthermore the level of collaboration with international and national scientific institutions, apart from that with the partner university;
9. It is recommended that the IQA Unit should have members in department and faculty level or it should be implemented the Academic Staff Performance Evaluation Manual. In this manual all evaluation procedures, levels and elements must be clear and transparent;
10. It is recommended to improve politics and processes of evaluation of implementation study program, students graduation and their insertion to work market or higher level studies;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al